



**Plehrat kimike në bujqësi, rekord. Rrapaj: Fermerëve do u duhen më shumë para për të punuar tokën**

Faqe 2



**Miratohet Skema Kombëtare e Bujqësisë 2026: Rriten subvencionet për lopët, bagëtitë dhe të mbjellat**

Faqe 12



**Ibrahimaj: Po monitorojmë çmimet e 80 produkteve për të shmangur abuzimet**

Faqe 5



# AGROBIZNESI

Rr. "Qemal Stafa", P. 9-katësh,  
Nr. 70, Kati 2, Pazari i ri, Tiranë.  
Tel: +355 4 2 251 910 /911  
Email: info@fedinvest.al  
kontakt@fedinvest.al  
www.fedinvest.al

## BOTIM I KËSHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR

Adresa: Rruga "Mine Peza", Pallati 87/3, Hyrja 1, Kati i parë, Tel/ Fax: 2229445  
E-mail: infokash@yahoo.com www.kash.org.al

15-ditëshi i dytë i muajit mars 2026

**Viti i shtatëmbëdhjetë i botimit - Nr. 530**  
Çmimi 125 lekë

E përdyjavshme e pavarur

**NGA FERMA TE TREGU EUROPIAN: STANDARDIZIMI DHE SIGURIA SI AVANTAZH KONKURRUES PËR SEKTORIN E BIMËVE MJEKËSORE DHE AROMATIKE (BAM)**

# SI TË PËRMIRËSOHEN KONTROLLI I CILËSISË, PAKETIMI DHE GJURMUESHMËRIA SIPAS KËRKESAVE TË BE-SË

*Organizata e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim Industrial (UNIDO), përmes Programit Global për Cilësi dhe Standarde (GQSP), të mbështetur nga Qeveria Zvicerane përmes Sekretariatit Shtetëror për Çështjet Ekonomike (SECO), po mbështet fermerët dhe ndërmarrjet e vogla e të mesme (NVM) në përmbushjen e standardeve të kërkuara, duke lehtësuar aksesin e tyre në tregjet evropiane dhe ndërkombëtare*

**ALBANIA**

**Programi Global Për Cilësi dhe Standarde**

UNITED NATIONS INDUSTRIAL DEVELOPMENT ORGANIZATION

Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike SECO



**Salla takim me blegtorët: Mbështetje për rritjen e cilësisë së qumështit dhe luftën kundër informalitetit**



Faqe 4

## FINANCIM

## BUJQËSI

**FED Invest mbështet fermerin në Kurbin, shembull i bujqësisë së qëndrueshme në Zhej**

**AZHBR forcon bashkëpunimin me Agjencinë e Pagesave të Kroacisë**

## PROJEKTI CRABOOST

**Karavasta në fokus të kërkimit shkencor. Nis projekti CRABOOST për menaxhimin e gaforres blu**

Faqe 2

## TEMA TË DITËS

Faqe 7

- Sipërmarrësit e rinj që "rishpikën" vajin e ullirit në Belsh Fq.4
- Betejë pas beteje - Si mund t'i mbijetojë prodhimi shqiptar zinxhirit global të krizave ushqimore? Fq.5
- Salla, takim me përfaqësuesen e BB-së për ecurinë e projektit CRAD Fq.6
- Vonesa në punimin e tokave, shkak moti i paqëndrueshëm, specialistët e bujqësisë udhëzojnë fermerët Fq.6
- Blegtoria në Shkodër, specialisti Brahja: Shqetësim mungesa e fuqisë punëtore Fq.6
- Kalendari bujqësor, muaji prill 2026 - Prof. As. Dr. Eqrem Meçollari Fq.13



Faqe 6

## TEMA TË DITËS

# Plehrat kimike në bujqësi, rekord. Rrapaj: Fermerëve do u duhen më shumë para për të punuar tokën

Kryetari i Këshillit të Agrobiznesit, Agim Rrapaj thotë se edhe në vendin tonë, shqetësimi është real sa i takon rritjes së çmimit për plehrat kimikë, për të punuar tokën.

Në një intervistë për "Money Report" në ABC News, Rrapaj u shpreh se fermerëve do i duhen më shumë para për të punuar tokën.

"Shqetësimi është real. Efekti është më i madh. Kemi flotën më të vjetër të rajonit, harxhon më shumë karburant

se vendet e rajonit. Ne kemi edhe një çmim të ngarkuar të naftës me taksa që të tjerët nuk i kanë. Ne nuk kemi rezerva. Jo për çmimin. Rezerva nuk influencon në çmim. Fermerit do i duhet më shumë para për të punuar tokën. Kostoja e produkteve do dalë shumë më e lartë. Edhe te plehrat kimikë u rrit menjëherë çmimi.

Askush nuk shet dhe hedh në treg plehra kimikë me çmime që nuk përputhet me kërkesë ofertën. Lind nevojë e

domosdoshme për më shumë para. Nëse nuk do hidhen më shumë para, patjetër që do kemi mangësi, veçanërisht te prishja e raportit kërkesë ofertë. Fermerët, edhe sot, dalin me kosto më të lartë. Një grupim fermerësh të caktuar, nuk kanë ku shesin produktet e tyre, për shkak të koston. Skema kombëtare e subvencionit të naftës të përmirësohet, të ketë mundësi që sa më shumë fermerë ta marrin naftën e rimbursuar", theksoi ai.

# Plehrat kimike në bujqësi, rekord. Fermerët në botë të shqetësuar nga efektet e luftës

Lufta në Iran po rrit çmimet për fermerët që janë tashmë të rënduar, me kosto më të larta për plehrat që përdorin për tokën dhe naftën.

Ekspertët paralajmërojnë se presioni në rritje mbi bujqësinë mund të çojë në çmime edhe më të larta në dyqanet ushqimore.

Çmimi për urenë e importuar, një formë e kristalizuar e azotit që përdoret në pjesën më të madhe të bujqësisë në botë, është rritur me gati një të tretën që kur SHBA-të dhe Izraeli sulmuan Iranin.

Lufta ka bllokuar në mënyrë efektive Ngushticën e Hormuzit, një pikë kyçe nëpër të cilën kalojnë një e pesta e naftës botërore dhe një e treta e plehrave të botës. Kjo është një tronditje për furnizimin global me plehra, ndërsa fermerët përgatiten për sezonin e mbjelljeve të pranverës, i cili fillon në mars.

Vende të rëndësishme prodhuese si Emiratet e Bashkuara Arabe, Arabia Saudite dhe Katarit nuk mund të transportojnë më furnizimet e tyre me ure dhe amoniak siç ishte planifikuar.

Lindja e Mesme është kritike për tregtinë globale të plehrave, me 35% të tregtisë globale të

uresë, një pleh i ngurtë azoti, që vjen përmes rajonit ndërsa afërsisht 20% e tregtisë së fosfatit vjen nga Arabia Saudite

Situata nuk është ende e krahasueshme me krizën energjetike të vitit 2022, kur

shkak të tarifave speciale të BE-së që zbatohen për plehrat ruse dhe bjelloruse.

Një mungesë e zgjatur e plehrave dhe një rritje e çmimeve të tyre mund të bëjnë që disa fermerë të mos i përdorin



ureja kushtonte më shumë se 1,000 euro për ton pasi shitësit me pakicë thonë se furnizimet për sezonin aktual janë në thelb të sigurta.

Sipas analistëve, çmimet e plehrave të azotit mund të dyfishohen ndërkohë që tregtarët në Evropën Perëndimore po i drejtohen përsëri alternativave ruse kur furnizimet nga Katarit dhe shtetet e tjera të Gjirit dobësohen. Kjo gjithashtu po rrit çmimet, pjesërisht për

fare ato duke ulur rendimentet e të korrave.

Kjo mund të ndikojë në sigurinë ushqimore në mbarë botën. Rendimentet më të ulëta për kulturat bazë si orizi, gruri, misri dhe soja do të kufizonin furnizimin global. Nga ana tjetër, kjo ka të ngjarë të rrisë çmimet e ushqimeve dhe potencialisht të krijojë mungesa lokale, veçanërisht në vendet që varren nga importi.



**PLEHRAT KIMIKE NE BUJQESI, REKORD**  
RRAPAJ: FERMEREVE JU DUHEN ME SHUME PARA PER TE PUNUAR TOKEN

Livestream worldwide: [abcnews.al/live](http://abcnews.al/live)

## Karavasta në fokus të kërkimit shkencor. Nis projekti CRABoost për menaxhimin e gaforres blu

Në Lagunën e Karavastës, një nga ekosistemet më të rëndësishme lagunore në Shqipëri

synon të adresojë ndikimin e rritje të gaforres blu në sektorin e peshkimit dhe biodiversitetin

e kampionimit, duke shënuar një hap konkret drejt studimit të pranisë dhe përhapjes së gaforres blu (*Callinectes sapidus*), një specie invazive që po ndikon ndjeshëm në aktivitetin tradicional të peshkatarëve.

Fushata u realizua në bashkëpunim me partnerë italianë dhe Organizatën e Menaxhimit të Peshkimit, duke sjellë një qasje të integruar mes ekspertizës ndërkombëtare dhe njohurive lokale. Gjatë këtij procesi, u testuan pajisje të ndryshme peshkimi, me qëllim identifikimin e metodave më efikase për kapjen dhe monitorimin e kësaj specije.

Sipas të dhënave paraprake të mbledhura në terren, në to-

tal u regjistruan 22 ekzemplarë të gaforres blu, me shpërndarje të ndryshme në zonat e kampionimit. Këto rezultate, ndonëse të hershme, japin një pasqyrë më të qartë mbi intensitetin e pranisë së kësaj specijeje në lagunë dhe shërbejnë si bazë për analizat e mëtejshme shkencore.

Peshkatarët vendas, të cilët çdo ditë përballen me sfidat që sjell kjo specie, janë ndër aktorët kryesorë të përfshirë në projekt. Për ta, prania e gaforres blu shpesh përkthehet në dëmtime të rrjetave dhe ulje të rendimentit të peshkimit tradicional, duke ndikuar drejtpërdrejt në të ardhurat e tyre.

Projekti CRABoost synon jo vetëm të kuptojë më mirë

dinamikën e përhapjes së gaforres blu, por edhe të krijojë mundësi të reja ekonomike, duke eksploruar potencialin e kësaj specijeje si burim alternativ për tregun. Në këtë kuadër, studimet do të shtrihen edhe në aspektet e zinxhirit të vlerës, përpunimit dhe promovimit të produkteve të reja të lidhura me këtë specie.

Një element i rëndësishëm i projektit është bashkëpunimi ndërkufitar dhe shkëmbimi i praktikave më të mira mes vendeve të rajonit të Adriatikut, të cilat po përballen me sfida të ngjashme nga speciet invazive detare.

CRABoost bashkëfinançohet nga Bashkimi Evropian

përmes Programit IPA South Adriatic, një instrument që mbështet zhvillimin e qëndrueshëm dhe bashkëpunimin rajonal në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Italisë jugore.

Ekspertët theksojnë se kjo fazë e parë është vetëm fillimi i një procesi më të gjatë monitorimi dhe ndërhyrjes, të cilat priten të kontribuojnë në mbrojtjen e ekosistemit të Karavastës dhe në forcimin e qëndrueshmërisë së sektorit të peshkimit.

Me këtë iniciativë, Shqipëria pozicionohet gjithnjë e më shumë si pjesë aktive e projekteve evropiane që synojnë menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe përballjen me sfidat e reja mjedisore.



dhe në rajonin e Adriatikut, ka nisur zbatimin në terren i projektit ndërkombëtar CRABoost, i cili

lokal. Gjatë ditëve të fundit, në këtë zonë u zhvillua fushata e parë



NGA FERMA TE TREGU EUROPIAN: STANDARDIZIMI DHE SIGURIA SI AVANTAZH KONKURRUES PËR SEKTORIN BAM

# SI TË PËRMIRËSOHEN KONTROLLI I CILËSISË, PAKETIMI DHE GJURMUESHMËRIA SIPAS KËRKESAVE TË BE-SË

Organizata e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim Industrial (UNIDO), përmes Programit Global për Cilësi dhe Standarde (GQSP), të mbështetur nga Qeveria Zvicerane përmes Sekretariatit Shtetëror për Çështjet Ekonomike (SECO), po mbështet fermerët dhe ndërmarrjet e vogla e të mesme (NVM) në përmbushjen e standardeve të kërkuara, duke lehtësuar aksesin e tyre në tregjet evropiane dhe ndërkombëtare

Përpunimi dhe tregtimi i bimëve mjekësore dhe aromatike (BAM) përfaqëson një nga sektorët më premtes të ekonomisë rurale në Shqipëri. Me një traditë të gjatë kultivimi dhe mbledhjeje, vendi ynë gëzon një reputacion të qëndrueshëm për cilësi, aromë dhe përbërje natyrore bioaktive. Megjithatë, konkurrenca globale dhe kërkesat gjithnjë e më të rrepta të Bashkimit Europian e bëjnë të domosdoshme që prodhuesit dhe përpunuesit shqiptarë të përshtatin praktika më të avancuara të kontrollit të cilësisë, gjurmueshmërisë dhe sigurisë së produktit. Kalimi drejt një zinxhiri të standardizuar dhe të dokumentuar jo vetëm rrit besueshmërinë e sektorit, por krijon bazën për eksport të qëndrueshëm dhe çmime më të larta tregu.



Në këtë kontekst, artikulli paraqet disa rekomandime praktike mbi mënyrën se si operatorët e sektorit BAM—nga fermerët, grumbulluesit dhe pikat e përpunimit, deri te eksportuesit—mund të përmirësojnë proceset përmes standardeve të BE-së si GACP, HACCP, ISO 22000, Organik, si dhe kërkesave të gjurmueshmërisë së tregut evropian. Qasja e duhur nuk kërkon vetëm investime, por edhe disiplinë teknike, dokumentim të saktë dhe kulturë cilësie në çdo hallkë të zinxhirit.

**Kodi i Praktikave të Mira Bujqësore dhe të Mbledhjes (GACP): Hapi i parë drejt cilësisë**  
Standardet e GACP janë themeli mbi të cilin ndërtohet cilësia e BAM-ve që nga ferma. Ato kërkojnë identifikim të saktë botanikal të bimëve, menaxhim të kontrolluar të tokës, ujitjes dhe plehërimit, si dhe përdorim të metodave të sigurta të mbledhjes. Për fermerët dhe mbledhësit shqiptarë, zbatimi i GACP nënkupton adoptimin e praktikave të mbijelljes, mbledhjes dhe tharjes, si dhe monitorimi i kushteve më kritike si lagështia dhe temperatura gjatë tharjes. Përtej nevojës së tregut, këto praktika përmirësojnë qëndrueshmërinë e prodhimit, ulin humbjet pas korjes dhe sigurojnë që çdo lot produkti të jetë i parashikueshëm dhe i kontrolluar.

Një sfidë e shpeshtë në terren është përzjerja e llojeve, kontaminimi me trupëza të huaja ose mosrespektimi i moshës së duhur të mbledhjes. Këto ndikojnë drejtpërdrejt në përbërjen kimike dhe vlerën e eksportit. Prandaj, formimi i kapaciteteve të grumbulluesve dhe puna me kooperativa apo GVV-e bëhet thelbësore për të mbajtur të njëjtin standard në zona të gjera prodhimi. GACP nuk është një dokument, por një kulturë e cila duhet të ndiqet në çdo hap. (Foto pasardhëse)

**Kontrollet laboratorike: garancia e sigurisë dhe standardizimit**

Bashkimi Europian kërkon që produktet e sektorit BAM të jenë të sigurta për konsumatorin dhe të mos përmbajnë



metale të rënda, pesticide, mikotoksina apo mikroorganizma të dëmshme. Për këtë arsye, analizat laboratorike të akredituara janë një detyrim për çdo lot të destinuar për eksport.

Rekomandohet që eksportuesit të vendosin protokolle të rregullta testimi për parametrat kryesorë: pH, lagështi, vajra esenciale, përbërje aktive, pesticide dhe kontaminime mikrobiale. Këto analiza duhet të ruhen dhe të jenë të aksesueshme për inspektimet e BE-së dhe klientët ndërkombëtarë. Përdorimi i laboratorëve të akredituar sipas ISO/IEC 17025 rrit besueshmërinë e certifikatave dhe shmang refuzimin e mallrave në doganat e BE-së.

Një praktikë e rëndësishme është marrja e mostrave për përfaqësim të plotë. Shpesh, eksportuesit hasin probleme kur mostra e analizuar nuk përfaqëson saktë të gjithë lotin, çka çon në mospërputhje cilësie. Standardet evropiane kërkojnë procedura të qarta të marrjes së mostrave, përzjerjes dhe ruajtjes së tyre deri në momentin e dorëzimit në laborator.

## Paketimi inteligjent: mbrojtje, ruajtje dhe marketing

Paketimi nuk është vetëm një mbështjellës; është një element kritik i cilësisë dhe një instrument marketingu që komunikon profesionalizëm dhe përputhshmëri me standardet ndërkombëtare. Për BAM-të, paketimi duhet të sigurojë mbrojtje nga drita, oksigjeni dhe lagështia, të jetë i përshtatshëm për natyrën higroskopike të bimëve, dhe të ruajë aromën dhe përbërjen aktive deri në destinacion.

Materialet e rekomanduara përfshijnë qeset me shumë shtresa të aprovuara për kontakt me ushqimin, kuti kartoni të fortifikuara dhe thasë me fibra natyrore të personalizuar. Gjithashtu, etiketimi sipas kërkesave të BE-së duhet të përfshijë: emrin botanikal, numrin e lotit, origjinën, datën e prodhimit, kushtet e ruajtjes dhe certifikimet (Organik, GACP, HACCP).

Në vitet e fundit, paketimi inteligjent po bëhet trend: përdorimi i sensorëve për monitorimin e lagështisë, QR-kodet për gjurmueshmëri dhe etiketat anti-manipulim rrisin nivelin e sigurisë dhe transparencës për konsumatorët. Për eksportuesit shqiptarë, adoptimi i këtyre teknologjive do të ishte një avantazh konkurrues i rëndësishëm. (Foto pasardhëse)

## Gjurmueshmëria: çelësi i besimit dhe hyrjes në treg

Sipas rregulloreve të BE-së, çdo produkt duhet të jetë i gjurmueshëm nga ferma deri te konsumatori. Kjo kërkon një sistem të qartë dokumentimi dhe evidentimi në të gjitha hallkat e zinxhirit. Gjurmueshmëria nuk është vetëm një detyrim, por edhe një mjet strategjik për të menaxhuar rrezikun dhe për t'i dhënë klientëve ndërkombëtarë garanci mbi origjinën dhe cilësinë e produktit.

Një sistem tipik i gjurmueshmërisë për BAM duhet të përfshijë: kodimin e lotit, regjistrimin e furnitorëve, doku-



mentimin e proceseve të tharjes, pastrimit, grirjes dhe paketimit, si dhe vegla digjitale që lehtësojnë ruajtjen dhe transmetimin e të dhënave. Përdorimi i platformave ERP, aplikacioneve mobile dhe databazave të centralizuara e bën më të lehtë menaxhimin e informacionit dhe përmbushjen e kërkesave inspektuese të BE-së.

Në praktikën më të avancuara, gjurmueshmëria mbështetet në teknologji të tilla si blockchain, të cilat sigurojnë transparencë të plotë dhe eliminim të manipulimeve të të dhënave. Ndërmarrjet shqiptare që synojnë tregun premium mund të eksplorojnë këto modele për t'u diferencuar nga konkurrenca.

## Sistemet e menaxhimit të cilësisë: rruga drejt qëndrueshmërisë së eksportit

Adoptimi i sistemeve të menaxhimit të cilësisë është një investim që shpërblen në afatgjatë. Standardet si ISO 22000, HACCP dhe GlobalG.A.P. jo vetëm rrisin sigurinë e produktit, por forcojnë besimin e partnerëve ndërkombëtarë dhe eliminojnë barrierat që mund të lindin në tregjet e BE-së.

Implementimi i këtyre sistemeve duhet parë si proces i vazhdueshëm, ku kompania identifikon rreziqet kryesore, harton procedura për kontrollin e tyre dhe trajnon stafin në mënyrë të vazhdueshme. Një ndër aspektet më të rëndësishme është auditimi i brendshëm, i cili ndihmon ndërmarrjen të identifikojë pikat e dobëta përpara se ato të shfaqen si problem tek klientët.

Ndërmarrjet shqiptare që kanë investuar në këto sisteme raportojnë rritje të stabilitetit të prodhimit, përmirësim të marëdhënive me blerësit dhe rritje të çmimit për njësi. Standardet nuk janë thjesht një kusht formal; ato krijojnë rend, disiplinë dhe profesionalizëm në menaxhimin e biznesit.

## Përfundim: cilësia dhe inovacioni, baza e konkurrueshmërisë së sektorit BAM

Për të ndërtuar një sektor të fortë, të qëndrueshëm dhe të aftë për të konkurruar në tregjet ndërkombëtare, Shqipëria duhet të përqendrohet në cilësinë, sigurinë dhe gjurmueshmërinë e produkteve të saj. BAM-të tona kanë potencial të madh natyror, por ky potencial nuk shfrytëzohet plotësisht pa investim në standarde, laboratorë, digjitalizim dhe paketim modern.

Rritja e kërkesave të BE-së duhet parë si mundësi, jo si pengesë. Ato na nxisin të përmirësohemi, të inovojmë dhe të ndërtojmë produkte me vlerë të lartë të shtuar. Përmes bashkëpunimit mes fermerëve, grumbulluesve, laboratorëve, institucioneve dhe ndërmarrjeve eksportuese, Shqipëria mund të pozicionohet si një qendër e rëndësishme e prodhimit të BAM-ve cilësore në Ballkan dhe Europë.

Shndërrimi i sektorit ndodh hap pas hapi: BAM të sigurta, paketim inteligjent dhe mbi të gjitha eksport i qëndrueshëm.

Kjo është formula e suksesit për të ardhmen e sektorit tonë

## Salla takim me blegtorët: Mbështetje për rritjen e cilësisë së qumështit dhe luftën kundër informalitetit

Ministri i Bujqësisë dhe zhvillimit Rural, Andis Salla qumështit”, ku u diskutua për nevojat dhe sfidat e sektorit të



zhvilloi një takim me shoqatën “Blegtorët prodhues të qumështit, një degë me potencial rritës në vend.

Gjatë takimit u diskutua mbi informalitetin në treg dhe nevojën për masa konkrete për reduktimin e tij.

Ministri Salla theksoi rëndësinë e bashkimit të blegtorëve në grupime si një mekanizëm për rritjen e cilësisë së prodhimit.

Ai bëri të ditur se përmes politikave të qeverisë shqiptare dhe mbështetjes përmes Skemës Kombëtare, do të vijojë përfundimi i këtij sektori jetik për sigurinë ushqimore dhe për mbrojtjen e konsumatorëve.

“Qeveria mbetet e përkushtuar në nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm të sektorit të qumështit dhe përmirësimin e standardeve të prodhimit”, u shpreh ministri.

## Sipërmarrësit e rinj që “rishpikën” vajin e ullirit në Belsh

Nga: Nora Kushti



Belsh, Shqipëri

A ju ka pyetur ndonjëherë dikush se ku e shihni veten në vitin 2030

Shumica prej nesh do të ndaleshin për të menduar. Shumica do të hezitoinin. Por Heraldo dhe Sabjani jo.

Ata e shohin 2030-ën qartë. Shohin rreshta me ullinj me ngjyrë argjendi-jeshile nën diellin shqiptar.

Shohin shishe me vaj ulliri ekstra të virgjër, të cilësisë premium, në raftet gourmet në gjithë Evropën. Shohin “Grekkan” të shfaqet me krenari në etiketa në Itali, në BE, madje edhe në SHBA.

Ata po e ndërtojnë të ardhmen e tyre vetë, ditë pas dite.

fshat në bashkinë e Belshit - një zonë e njohur për 84 liqenat e saj të mrekullueshme dhe traditat shekullore të ullirit - dy të rinj vendosën të ndalonin së prituri që “mundësia” t’u vinte nga qielli.

Ata do ta krijonin vetë atë. Njëri kishte kaluar dhjetë vite në emigracion. Tjetri kishte përjetuar zhgënjimin e një biznesi që nuk pati suksesin që ai mendonte.

Të dy e njihnin pasigurinë. Të dy e dinin çfarë do të thoshte të filloje nga zero.

Por ata dinin edhe diçka tjetër: toka e tyre kishte 1,500 deri në 2,000 rrënjë ullinj.

Ullinj të tjerë janë të durueshëm.



Heraldo Cekrezi dhe Sabjan Rusta

Në zemër të Grekanit, një Ata “kthehen” çdo vit. Edhe

ata u kthyen.

Në vitin 2022, Heraldo Cekrezi dhe Sabjan Rusta regjistruan Grekan shpk.

Jo thjesht si një kompani - por si një angazhim.

Fabrika e tyre qëndron në qendër të fshatit, një godinë njëkatëshe e rinovuar, e dedikuar tërësisht për prodhimin e vajit të ullirit.

Çdo vit, 150-170 fermerë sjellin ullinj të tyre aty. 85 tonë vaj ulliri përpunohen dhe 25 tonë shiten vetëm në një sezon. Ata punësojnë pesë deri në gjashtë persona në punë sezonale. Dhjetëra familje varen nga ky shërbim.

Rezultati është më shumë se vaj.

Është vlerë lokale.

Të ardhura lokale.

Dinjtet lokal.

Por të arrije deri këtu nuk ishte e lehtë. Ata e dinë mirë këtë. Një linjë kredie afatgjatë rëndonte mbi ta. Kishte sezona ulliri të vështira.

### Pika e kthesës: Metodologjia “Rritu me Biznesin Tënd”

Një ditë të zakonshme, ata morën një telefonatë nga Drejtoria e Bujqësisë në Bashkinë e Belshit. Ata po konsideroheshin si “kandidatë” potencialë të metodologjisë “Rritu me Biznesin Tënd” (GYB), mbështetur nga UNDP në kuadër të një programi më të gjerë: Bashkëpunimi me Sipërmarrjen dhe Zgjidhjet për Arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, financuar nga Qeveria e Suedisë dhe zbatuar nga UNDP në partneritet me FAO, ILO dhe UNIDO.

Heraldo dhe Sabjani mund të kishin thënë: “Ne dimë tashmë si të bëjmë vaj ulliri.”

Në vend të kësaj, thanë: “Dinamikat e biznesit ndryshojnë

(Vijon në faqen 11)

## Garancia sovrane në bujqësi, nevojë për rishikim - Këshilli i Investimeve: Të analizohen kostot dhe procedurat administrative

Këshilli i Investimeve rekomandon nevojën për rritjen e nivelit të shfrytëzimit të skemave të garancisë së kredisë, duke iu referuar konkretisht Garancisë Sovrane në Bujqësi. Në raportin vjetor 2025, Këshilli nënvizon domosdoshmërinë e rishikimit të kostove dhe procedurave administrative për të kontribuar në përmirësimin e aksesit të bizneseve në financë.

Në fillim të vitit 2025 është prezantuar skema e garancisë sovrane për bujqësinë, një instrument i ri financiar që synon të përmirësojë aksesin në financim për fermerët dhe agrobizneset në vend. Nisma vjen në kuadër të përpjekjeve për të rritur përdorimin e skemave të garancisë së kredisë dhe për të përmirësuar mundësitë e financimit për sektorin bujqësor.

Skema ofron norma interesi të subvencionuara për agrobiznese që variojnë nga 2% deri në 3.5%, ndërsa përmes fondit të garancisë së shtetit mbulohet deri në 70% e shumës së kredisë pa kërkuar kolateral. Ky mekanizëm synon të ulë rrezikun për institucionet financiare dhe të krijojë më shumë mundësi për fermerët që të sigurojnë financim për investime.

Programi synon të nxisë investimet në zonat rurale, të rrisë nivelin e formalizimit të aktiviteteve bujqësore dhe

të përmirësojë konkurrueshmërinë e sektorit në treg. Sipas Ministrisë së Bujqësisë po asistohen fermerët dhe agrobizneset në të gjithë Shqipërinë në mënyrë që ta bëjnë sa më të shfrytëzueshëm këtë instrument.

Qeveria shqiptare ka lidhur marrëveshje me 11 banka



tregtare në vend për të bërë të mundur aplikimin e garancisë sovrane në sektorin bujqësor.

Garancia Sovrane me fond prej 3 miliardë lekësh, ose 30 milionë euro është një instrument që stimulon huadhënien nga bankat për t’i mundësuar ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme në sektorin e bujqësisë si dhe fermerëve të pajisur me NPT, investime për asete fizike dhe teknologjike që rritin kapacitetet prodhuese, cilësinë e prodhimit dhe efi-

ciencën operacionale të tyre.

Sipas marrëveshjes, qeveria merr përsipër të paguajë 70 % të huasë së marrë nga bankat në rastin kur nuk shlyhet nga huamarrësi, por nuk merr përsipër garantimin e interesave, kama-tëvonesave dhe penaliteteve apo çdo lloj detyrimi tjetër monetar që buron nga huatë.

Referuar marrëveshjes, totali i kredive të dhëna nga bankat për një huamarrës nuk duhet të kalojë vlerën prej 250 mijë euro dhe afati i kredisë nuk mund të jetë më i ulët se tre vjet dhe më i lartë se 5 vjet. Megjithatë, deri më tani nuk janë publikuar të dhëna zyrtare mbi nivelin e përthithjes së fondeve nga kjo skemë, dhe pse më herët është bërë një analizë për të evidencuar problematikat që ka kjo skemë dhe arsyen pse nuk ka interes të lartë.

## Ibrahimaj: Program mbështetjeje për përpunimin e mishit dhe ligj për produktet “Made in Albania”

Ministrja e Ekonomisë dhe Inovacionit, Delina Ibrahimaj, zhvilloi një takim me përfaqë-

ren për të ndihmuar prodhuesit vendas.

Ministrja Ibrahimaj thek-



sues të Ministrisë së Bujqësisë, Autoritetit Kombëtar të Ushqimit dhe Këshillit Ekonomik Kombëtar, ku u diskutua për zhvillimin e sektorit të përpunimit të mishit dhe hartimin e një programi mbështetjeje për sipërmarrjen shqiptare.

Takimi u fokusua në përgatitjen e bizneseve për procesin e integritimit në Bashkimin Europian, duke analizuar standardet që kërkon tregu i BE-së dhe masat që duhet të ndërmer-

soi se ky është një moment i rëndësishëm për të forcuar bashkëpunimin me sektorin privat.

“Ky është një moment kyç për të bashkëpunuar më ngushtë me biznesin, në mënyrë që sektori prodhues shqiptar të përgatitet për mundësitë që sjell integrimi në Bashkimin Europian,” deklaroi ajo.

Në të njëjtën kohë, Ibrahimaj njoftoi se po punohet për një projektligj të ri “Për produktet

Made in Albania”, i cili synon promovimin e prodhimit vendas dhe rritjen e konkurrueshmërisë së produkteve shqiptare në treg.

“Diskutuar me përfaqësues të sektorit të përpunimit të mishit për programimin e sektorëve të prodhimit në Shqipëri. Këto tryeza janë pjesë e punës për hartimin e një programi mbështetjeje për sipërmarrjen shqiptare në procesin e integritimit evropian, duke identifikuar standardet që kërkon tregu i BE-së dhe masat që duhen ndërmarrë për të mbështetur bizneset. Në të njëjtën kohë, po punojmë për një projektligj për produktet ‘Made in Albania’, që synon të promovojë prodhimin vendas dhe të forcojë pozicionin e produkteve shqiptare në treg. Ky është një moment i rëndësishëm për të bashkëpunuar më ngushtë me biznesin, në mënyrë që sektori prodhues shqiptar të përgatitet sa më mirë për mundësitë që sjell integrimi në Bashkimin Europian.”-shkruan ministrja në reagimin e saj.

# Betejë pas beteje - Si mund t'i mbijetojë prodhimi shqiptar zinxhirit global të krizave ushqimore?



Ngjashëm me skenarin e filmit "One battle after the other" ku protagonisti përballet me një betejë të re sapo ka përfunduar një tjetër, ekonomia globale dhe ajo shqiptare po kalojnë nga një krizë në tjetrën. Ende pa e marrë veten plotësisht nga tronditja e zinxhirëve të furnizimit prej pandemisë, bota u përball me luftën në Ukrainë, e cila shkaktoi tronditje, përmbyse dhe ndryshime strukturore në tregjet e drithërave, plehrave kimike dhe energjisë.

Sot, tekta plagët e asaj krize janë ende të hapura, një tjetër front konflikti në Lindjen e Mesme po kërcënon me forcë përsëri tregjet globale. Kjo seri krizash të njëpasnjëshme po krijon një efekt domino që godet drejtpërdrejt themelet e prodhimit bazë të ushqimit: bujqësinë.

Situata ngjan frikshëm me periudhën e menjëhershme pas fillimit të luftës në Ukrainë. Problemet në furnizimin me naftë dhe gaz dhe pasiguria posjellin rritje të larta të çmimeve veçanërisht të gazit, i cili është bazë për prodhimin e inpueteve bujqësore, plehrat kimike azotike por edhe ato fosfatike. Paralelisht, nafta po njej rritje te shpejtë, duke shtrenjtuar në mënyrë të pashmangshme koston e përdorimit të mekanikës bujqësore, koston e transportit të produkteve nga ferma në tregje, dhe atyre të përpunimit sepse energjia, ambalazhimi e çdo kosto janë shtrenjtuar.

Përballë këtij presioni në rritje, është e rëndësishme të kuptojmë se me çfarë masash mund të mbrohet bujqësia shqiptare. Janë në fuqi disa mekanizma mbështetës, ku përfshihen skema e naftës pa taksa, e cila zhvesh karburantin jo vetëm nga akciza, por edhe nga taksa e qarkullimit dhe taksa e karbonit për punimet e mekanizuara bujqësore, politikat e subvencionimit të drejtpërdrejtë përmes Skemës Kombëtare, të cilat ofrojnë mbështetje financiare për sipërfaqe të mbjellja apo për krerë në blegtori, si dhe kompensimi i TVSH-së prej 10% mbi çmimin e shitjes së produkteve tek bizneset (grumbulluesit/përpunuesit) për fermerët e vegjël. Këto janë instrumentet bazë që supozohet të mbajnë gjallë dhe nxisin prodhimin vendas.

Por a janë të mjaftueshme këto masa? Dilema e madhe

me të cilën përballet sot Shqipëria është e dyfishtë: si të mos lejojmë që rritja e kostove prej krizës së fundit të mos falimentojë prodhuesit vendas dhe, në të njëjtën kohë, si të garantojmë që prodhimet ushqimore vendase të mos kenë çmime të papërbalueshme për shqiptarët.

Për t'i dhënë përgjigje kësaj pyetjeje, le të ndalemi te një nga këto mekanizma ekzistues, ai që shpesh trumbetohet si një lehtësim i madh: kompensimi i TVSH-së së inpueteve për fermerët e vegjël. Kjo nuk është një masë emergjence e lindur si pasojë e luftës, por një politikë e mëparshme, në një linjë me praktikën e Bashkimit Evropian. Ndonëse në letër kjo masë synon të kompenzojë TVSH-në e inpueteve dhe të ulë koston për fermerët, në praktikë ajo vuan nga dy probleme thelbësore që po u rëndojnë atyre. Së pari, procedura kërkon që fermerët të sigurojnë faturat tatimore nga bizneset me TVSH blerëse.

Në realitet, bizneset shpesh nuk lëshojnë fatura ose i lëshojnë ato me çmime jo reale (fiktive), dhe nga ana tjetër, shpesh edhe vetë fermerët nuk i kërkojnë ato. Kjo praktikë duhet të ndryshojë. Së dyti, dhe më problematiku, rimbursimi i këtyre parave nga shteti vonon me muaj të tërë—me limite që shkojnë 7 deri në 8 muaj. Kjo do të thotë që fermeri merr mbarsht paratë "cash" me vonesa të stërzgjatura, duke e lënë atë zbuluar dhe pa likuiditet pikërisht në momentin kur i duhet të blejë urgjentisht plehrat kimike dhe naftën me çmimet e reja të rritura nga krizat.

Përballë këtij realiteti, nevojitet ndryshimi i skemës së TVSH-së së inpueteve, duke qënë proaktiv dhe i menjëhershëm. Në bujqësi koha është kritike: ne nuk mund të presim që pasojat e krizës të thellohen, pasi çdo vonesë sot përkthehet në dështim të prodhimit nesër. Si hap i parë afatgjatë, nevojitet ulja e kohës së rimbursimit në maksimumi 3 muaj, e shoqëruar me kontrolle të rrepta ndaj grumbulluesve për lëshimin e faturave dhe ndërgjegjësim të fermerëve që t'i kërkojnë ato. Por si të mbrojmë prodhimin nga rritja aktuale e frikshme e çmimit të inpueteve?

Masa e parë mund të jetë pezullimi i TVSH-së së inpueteve nga 10% që është tani në zero, por si politikë kjo fsheh një rrezik afatgjatë: çdo praktikë

"zero" TVSH e instaluar është jashtëzakonisht e vështirë të zhbëhet në kohë normaliteti. Ndaj, kompromis i mirë dhe aksion i duhur është një "pezullim i përkohshëm" me afat të përcaktuar paraprakisht ose një reduktim emergjent i saj vetëm për kohëzgjatjen e krizës.

Paralelisht, vetë skema e kompensimit me 10% të çmimit, e cila kur nuk paguhet TVSH për inputet duhet të bjerë, duhet të ruhet dhe të funksionojë si mjet strategjik nxitës dhe proteksionist i përkohshëm, por edhe sepse shumë faktorë do të paguhen nga fermerët me TVSH, si energjia elektrike, shërbimet agronomike, veterinare, transporti, etj. Të aplikohet një kompensim prej 5% të vlerës për produktet që eksportohen dhe në 10% të vlerës për ato që shiten në tregun vendas nga fermerët e vegjël. Kjo lëvizje mund të bëhet pa ndikuar shumë në strukturën kombëtare tatimore, por e ruan prodhimin dhe mund ta rrisë atë duke e orientuar drejt tryezave shqiptare si dhe ul varësinë nga importet me çmime tepër të larta e në situata të vështira tregjesh e transporti.

Përtej TVSH-së, një tjetër politikë që kërkon analizë urgjente është vetë Skema Kombëtare e mbështetjes. Aktualisht, kjo skemë ka specifika të përcaktuara: ajo mbulon naftën pa taksa (akcizë, qarkullim dhe karbon), jep subvencione për krerë në blegtori dhe mbështet sipërfaqet e mbjellja, me theks të veçantë te serat.

Por, a duhet riparë kjo skemë apo të lihet siç është? Në kushtet e një krize globale, ku koston e plastmasit për serat, plehrave kimike dhe ushqimit për bagëtinë po rriten përditë, vlera e subvencionit fiks për njësi rrezikon të zhvlerësohet plotësisht. Për më tepër, shpesh fondet vjetore shterojnë shpejt dhe kriteret lënë jashtë shumë fermerë të vegjël.

Ndaj, përpara se të krijohen masa të reja, duhet të vendosim nëse kjo skemë bazë ka nevojë për një rishikim të shpejtë dhe të thellë të buxhetit dhe kriterëve për t'iu përgjigjur realitetit të ri të çmimeve. Pra, për të fituar këtë "betejë pas tjetrës", është e qartë se nuk mjaftojnë vetëm politikat e vjetra, rimbursimet e vonuara apo skemat e zhvlerësuar. Nevojitet një paketë e plotë emergjence. Çfarë duhet bërë tjetër?

**Zgjerimi dhe thjeshtimi i skemës së naftës pa taksa:** Skema aktuale që heq akcizën, taksën e qarkullimit dhe atë të karbonit është një bazë e mirë, por rritja e çmimit në bursë do të jetë sërish në faturë për fermerin. Kjo skemë duhet të zgjerohet për të mbuluar 100% të nevojave reale (normativave) të prodhuesve dhe të zhvishet nga çdo burokrat e tepërt që pengon fermerët e vegjël të përfitojnë prej saj.

(Vijon në faqen 11)

# Programi i Praktikave të Punës - Ministri Salla: Mundësi reale për të rinjtë në bujqësi dhe sigurinë ushqimore

Të rinjtë shqiptarë po gjejnë gjithnjë e më shumë mundësi për të hyrë në tregun e punës falë Programit

qëllim të lidhë të diplomuarit me institucionet dhe bizneset, po prodhon histori suksesi që tregojnë se praktika e punës



Kombëtar të Praktikave të Punës, i cili po shënon rezultate konkrete në sektorë të ndryshëm të ekonomisë, përfshirë bujqësinë dhe zhvillimin rural.

Ky program, i cili ka për

mund të shndërrohet në një karrierë të qëndrueshme.

Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Andis Salla, solli shembullin e Havjolës, një 24-vjeçare e diplomuar në Bioteknologji, e cila

# Ibrahimaj: Po monitorojmë çmimet e 80 produkteve për të shmangur abuzimet

Institucionet kanë rritur mbikëqyrjen e tregut, duke vendosur nën monitorim të paktën 80 produkte bazë ushqimore, në përpjekje për të parandaluar abuzimet me çmimet në kushtet e tensioneve gjeopolitike dhe efekteve zinxhir që ato po shkaktojnë në tregjet ndërkombëtare.



Masa vjen pas përshtetësimit të konfliktit mes SHBA, Izraelit dhe Iranit, që ka rritur pasigurinë në furnizime dhe koston globale.

Në një konferencë për shtyp këtë të premte, Ministria për Ekonominë dhe Inovacionin, Delina Ibrahimaj, tha se lista e produkteve është hartuar në bashkëpunim me Institutin e Statistikave dhe se monitorimi po kryhet në baza ditore nga Inspektorati i Mbikëqyrjes së Tregut.

"Sa i takon ushqimeve ne po i monitorojmë një shportë me 80 ushqime me bazë ditore dhe ka filluar të reflektohen në disa produkte të shportës çmime të rritura pikërisht për këtë arsye ne do të aktivizojmë disa grupe

monitorimi nga ISHMT për të monitoruar realitetin e këtyre çmimeve.

Ne kemi zgjedhur në bashkëpunim me INSTAT një numër ushqimesh dhe një numër të limituar të tregtarëve dhe do të shohim çmimet dhe furnizimet për të parë realitetin e tyre. Nëse do të marrim

pas një praktike 3-mujore në Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, arriti të sigurojë një kontratë 1-vjeçare pune falë performancës së saj pozitive.

Salla e cilësoi këtë rast si një model frymëzues për të rinjtë që duan të ndërtojnë karrierë në sektorë kyç të ekonomisë, duke theksuar se përmes thirrjes së 10-të të programit, Havjola ka vijuar angazhimin në fushën e shëndetit dhe mbrojtjes së bimëve, duke inkurajuar edhe bashkëmoshatarët e saj të aplikojnë.

"Përmes thirrjes së 10-të të këtij programi, Havjola ka vijuar angazhimin në fushën e shëndetit dhe mbrojtjes së bimëve, duke inkurajuar edhe bashkëmoshatarët e saj që të aplikojnë dhe të përfitojnë nga mundësitë që ofron ky program për zhvillimin profesional dhe integrimin në tregun e punës", shkruan ministri Salla.

tregun vendas.

"Çmimi i bursës është rritur me 99.7 për qind. Nuk ka një pasqyrim direkt të të njëjtës vlerë dhe përmasë dhe në çmimet vendase. Mekanizmi që përdoret është një formulë ai i aktit normativ të vitit 2022 kur kishim një situatë të ngjashme që bazohet në çmimet bursës të një dite më parë dhe një llogaritje mbi koston dhe duke shtuar një marzh 3 lekë për shumicën dhe 12 lekë për pakicën. Këto nuk janë marzhe fitimi por përballimi të shpenzimeve që kompanitë kanë.

Ne me bordin e transparencës do të jemi në monitorim të çmimeve. Në një situatë kur çmimet po rriten në mënyrë të vazhdueshme të jemi transparente dhe mos lejojmë asnjë spekulim mbi konsumatorin.

Këtë po bëjë dhe për shportën e ushqimeve që kanë pasur disa luhatje gjatë ditëve të fundit dhe kemi nisur monitorimin ditore me INSTAT por do të nisim një mbikëqyrje më të thelluar me ISHMT që nga funksionet që ka është mbrojtja e konsumatorit. Efektet luftës të kenë sa më pak ndikim tek konsumatorët dhe që tregu po funksionon normalisht dhe pa abuzime nga situatë", tha Ibrahimaj.

Ministria u ndal gjithashtu te performanca ekonomike e vendit, duke theksuar se ekonomia shqiptare u rrit me 3.8% gjatë vitit 2025, një normë mbi mesatarin e Bashkimit Evropian dhe vendeve të Ballkanit, duke reflektuar qëndrueshmëri pavarësisht presioneve të jashtme.

## BUJQËSIA

## Salla, takim me përfaqësuesen e BB-së për ecurinë e projektit CRAD

Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Andis Salla në Bankën Botërore në vijim të monitorimit të vazhdueshëm



zhvilloi një bashkëbisedim me Xiaoqing Yu, drejtore e Divizionit për Ballkanin Perëndimor të projektit “Qëndrueshmëria ndaj Klimës dhe Zhvillimi i Bujqësisë”, (CRAD).

Gjatë takimi Salla dhe Yu diskutuan ecurinë e projektit dhe hapat konkretë për përshtetjen e zbatimit në mbështetje të zhvillimit të sektorit bujqësor dhe procesit të integritimit evropian.

Ministri Salla u shpreh se “përmes bashkëpunimit të ngushtë me Bankën Botërore do të garantojmë zbatimin efektiv të projektit dhe maksimizimin e përfitimeve për fermerët dhe sektorin bujqësor”.

Projekti CARD synon përmirësimin e zinxhirit ushqimor nga ferma në tavolinë, rritjen e vlerës së produkteve bujqësore, forcimin e sigurisë ushqimore dhe garantimin e sistemeve moderne të vaditjes dhe kullimit.

## AZHBR forcon bashkëpunimin me Agjencinë e Pagesave të Kroacisë

Drejtoresha e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR), Ardita Kuçi zhvilloi takim pune me delegacionin nga Agjencia e Pagesave të Kroacisë, në kuadër të forcimit të bashkëpunimit dypalësh në sektorin e bujqësisë.

Delegacioni kroat u kryesua nga sekretari i Shtetit për Bujqësinë dhe Çështjet Ndërkombëtare, Zdravko Tušek, si dhe drejtori i përgjithshëm i Agjencisë së Pagesave, Nikola Dolački.

Gjatë takimit, Kuçi vuri theksin te rëndësia e forcimit të dialogut institucional dhe zgjerimit të bashkëpunimit në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian.

Diskutimet u përqendruan në përmirësimin e Sistemit të Identifikimit të Parcelave Bu-



jqësore (LPIS), komponent kyç i Sistemit të Integruar të Administrimit dhe Kontrollit (IACS), ndërtimin e regjistrimit të fermës, menaxhimin financiar dhe mekanizmat e kontrollit, si dhe në procesin e akreditimit të agjencisë së pagesave.

Kuçi e cilësoi takimin hap të rëndësishëm në vijimin e bashkëpunimit konkret me partnerët ndërkombëtarë, me synim përbushjen e standardeve të BE-së dhe rritjen e eficiencës në mbështetjen e sektorit bujqësor.

## Blegtoria në Shkodër, specialisti Brahja: Shqetësim mungesa e fuqisë punëtore

Blegtoria në qarkun e Shkodrës vijon të mbetet një nga sektorët kryesorë të ekonomisë bujqësore, por përballet me sfida të vazhdueshme.

Sipas specialistëve të bujqësisë, fermerët kanë nisur që në këtë periudhë përgatitjet për sigurimin e bazës materiale për dimrin, duke punuar për grumbullimin e foragjereve dhe rezervave ushqimore për bagëtinë.

“Blegtoria ka një punë gjithëvjetore duke siguruar bazë ushqimore jo vetëm për momentin por për të gjithë vitin”, u shpreh Sherfi Brahja, Specialist, AREB Shkodër.

Megjithatë, një ndër problemet më të mëdha mbetet mungesa e fuqisë punëtore. Brahja thotë se blegtoria sot mbahet kryesisht nga moshat e treta. Kjo situatë ka ndikuar drejtpërdrejt edhe në reduktimin e sipërfaqeve të mbjella,

ku një pjesë e konsiderueshme e tokave bujqësore po mbeten djerrë për shkak të mungesës së punëtoreve.



“Problem është fuqia punëtore dhe mungesa e saj ka bërë që shumë toka të mbeten djerrë”, tha ai.

Pavarësisht vështirësive,

fermerët vijojnë të mbajnë gjallë traditën e blegtorisë në Shkodër, por pa ndërhyrje konkrete për të zgjidhur mung-

esën e fuqisë punëtore dhe për të nxitur punësimin në zonat rurale, ky sektor rrezikon të tkurret edhe më tej nga viti në vit.

## Fushata e mbjelljeve pranverore, fermerët përballen me rritje kostosh

Ka nisur zyrtarisht fushata e mbjelljeve pranverore në periudhë është vendimtare për ecurinë e prodhimit gjatë



vend, ndërsa fermerët janë angazhuar në përgatitjen e tokës dhe mbjelljen e kulturave të para bujqësore. Eksperti i bujqësisë në Shkodër, Sherif Brahja, shprehet se kjo

gjithë vitit, ndërsa kulturat që po mbillen janë qepët, patatet etj.

“Fushata ka filluar me mbjelljen e patates, qepujkës dhe qepës si kultura që e kanë pra-

gun e mbjelljes në temperatura relativisht më të ulëta se sa kulturat e tjera. Vazhdon fushata më pas me mbjelljen e jonxhës, ndërsa në prill është fushata e misrit, fasules dhe bimëve të tjera perimore të fushës,” – shprehet Brahja.

Sipas ekspertit, çmimet e inputeve bujqësore kanë pësuar rritje, duke përfshirë farërat, plehrat kimike dhe produktet mbrojtëse. “Kulturat që kanë kosto më të lartë dhe fitim më të ulët janë gruri, ndaj sipërfaqet e mbjelljes së grurit janë në minimum,” – shton ai.

Ecuria e këtij sezoni pritet të jetë një tregues i rëndësishëm për qëndrueshmërinë e sektorit, i cili vijon të mbetet një nga shtyllat kryesore të ekonomisë në vend.

## Masa për çrrënjosjen e tuberkulozit, Salla: Mbi 247 mijë krerë gjedhë të gjurmuar në 2025-ën

Në kuadër të Dita Botërore e Tuberkulozit, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka rikonfirmuar angazhimin për kontrollin dhe çrrënjosjen e tuberkulozit në gjedh, si një element kyç për mbrojtjen e shëndetit të kafshëve, garantimin e sigurisë ushqimore dhe avancimin e Shqipërisë drejt integritimit evropian.

Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Andis Salla, bëri të ditur se gjatë vitit 2025 janë gjurmuar në total 247.701 krerë gjedhë në të gjithë vendin, duke mundësuar identifikimin dhe ndërhyrjen në kohë për çdo rast pozitiv të konstatuar.

Sipas tij, këto masa janë pjesë e përpjekjeve për përbushjen e standardeve të Bashkimit Evropian, në kuadër të Kapitullit 12 që lidhet me sig-

urinë ushqimore, politikën veterinarë dhe fitosanitare.

Në këtë drejtim, institucionet po punojnë për ndërtimin e një sistemi të qëndrueshëm dhe të besueshëm, përmes forcimit të disa komponentëve kyç, si: gjurmueshmëria e kafshëve, kontrolli i lëvizjeve të tyre, regjistrimi i fermave, rritja e kapaciteteve laboratorike diagnostikuese si dhe zbatimi i masave të biosigurisë në fermë.

Ministri Salla ndau në rrjetet sociale momente nga puna që po kryejnë veterinerët për vaksinimin e gjedhit në një fermë në komunën Gjilapal, fshati Likesh.

“Kjo fermë ka 40 krerë lopë që mbarështon dhe çdo vit ne kryejmë provën e gjurmimit për tuberkulozin, me qëllim mbrojtjen e shëndetit

të kafshëve blegtorale, garantimin e biosigurisë ushqimore dhe mbrojtjen e shëndetit të njerëzve”, u shpreh një nga veterinerët që po kryen kontrollin në këtë fermë.

Gjurmueshmëria për tuberkulozin në kafshët bujqësore është një domosdoshmëri për mbrojtjen e shëndetit të kafshëve, garantimin e sigurisë ushqimore dhe ruajtjen e shëndetit publik.

MBZHR u bën thirrje të gjithë fermerëve që të bashkëpunojnë ngushtë me shërbimin veterinar dhe të respektojnë programet kombëtare të kontrollit, me qëllim zbatimin efektiv të tyre dhe ndërtimin e një sektori blegtoral më të sigurt, më të qëndrueshëm dhe konkurrues në tregun evropian.

## Vonesa në punimin e tokave, shkak moti i paqëndrueshëm, specialistët e bujqësisë udhëzojnë fermerët

Në bashkinë e Sarandës, moti i paqëndrueshëm ka shkaktuar vonesa në punimin



e tokave bujqësore. Fermerët janë përballur me vështirësi, pasi kushtet e lagështa kanë penguar hyrjen e mjeteve bujqësore në parcela. Sipas specialistëve të bujqësisë në Bashkinë e Sarandës, me përmirësimin e

kushteve atmosferike, puna në terren ka rifilluar me intensitet të lartë. Fermerët po shfrytëzojnë çdo mundësi për të rikuperuar kohën e humbur dhe për të vijuar procesin e përgatitjes së tokës.

Drejtori i bujqësisë, Mustafa Lama, u shpreh “Si rezultat i përmbytjeve dhe shirave të vazhdueshëm nuk arrinim që të fusnim mjetet bujqësore për të punuar. Gjithmonë, në pritje të përmirësimit të motit, është shtyrë në kohë, kështu që edhe mbjellja e misrit është shtyrë pak. Megjithatë jemi ende në afatet.”

Bashkia e Sarandës di-

sponon rreth 2.375 hektarë tokë bujqësore, nga e cila 92% mbillet kryesisht me kulturën e misrit dhe foragjere.

“Kjo është bërë e mundur si rezultat i pastrimeve të kanaleve vaditëse dhe kulluese, duke e çuar ujën në çdo parcelë të mbjellë.”

Në këtë situatë, fermerët po vijojnë punën duke u mbështetur edhe në këshillat e specialistëve të bujqësisë, me synimin që të shmangen dëmet e mundshme dhe të sigurohet një zhvillim sa më i mirë i sezonit bujqësor në vijim.

# Bashkëpunimi Kinë-Shqipëri, ambasadorja Pang Chunxue: Media dhe shkëmbimet njerëzore, çelësi i një kapitulli të ri

Në një pritje me përfaqësues të mediave shqiptare, Ambasadorja e Kinës në Tiranë, Pang Chunxue, vuri në dukje rëndësinë e bashkëpunimit konkret dhe të shkëmbimeve ndërnjerëzore si shtylla kryesore për forcimin e marrëdhënieve mes dy vendeve.

të 15-të Pesëvjeçar”, duke ofruar një “listë mundësish” për ekonominë globale.

## Kina si motor i ekonomisë globale

Ambasadorja artikuloi qartë rolin e Kinës në ekonominë botërore, duke theksuar se ven-

tregtar të hapur dhe të drejtë.

“Kina do të vazhdojë të mbështesë sistemin tregtar shumëpalësh”, deklaroi ajo, duke vënë në dukje rolin e Organizata Botërore e Tregtisë në këtë drejtim.

Ajo rikujtoi se Kina është partneri kryesor tregtar për më shumë se 160 vende dhe rajone, duke u pozicionuar si një “gurthemel sigurie” dhe “liman stabiliteti” për ekonominë globale.

## Marrëdhëniet Shqipëri-Kinë në rritje

Një pjesë e rëndësishme e fjalës iu kushtua marrëdhënieve me Shqipëri, të cilat sipas saj po zhvillohen në mënyrë të qëndrueshme.

“Gjatë vitit të kaluar, marrëdhëniet Kinë-Shqipëri kanë përparuar vazhdimisht dhe miqësia tradicionale ‘Distanca e largët, zemrat e afërta’ është më e fortë se kurrë”, u shpreh ambasadorja.

Ajo bëri të ditur se tregtia dypalëshe ka arritur në 1.577 miliardë dollarë, me një rritje prej 20.16% krahasuar me një vit më parë, duke e renditur Kinën si partnerin e dytë tregtar të Shqipërisë.

## Bashkëpunimi konkret dhe shkëmbimet kulturore

Në aspektin e bashkëpunimit konkret, Pang Chunxue përmendi nënshkrimin e një memorandumi bashkëpunimi sportiv mes Komiteteve Olimpikë të dy vendeve, si dhe dorëzimin e pajisjeve sportive.

Ajo vlerësoi gjithashtu rritjen e shkëmbimeve kulturore dhe turistike, duke theksuar se “27,800 turistë kinezë vizituan Shqipërinë gjatë vitit të kaluar”, një rekord për vitet e fundit.

Aktivitetet si Java e Kulturës Kineze dhe Festivali i Ushqimit Kinez kanë ndihmuar në afërsimin e mëtejshëm të dy popujve.

## Thirrje për thellimin e bashkëpunimit

Në përmbyllje, ambasadorja kineze riafirmoi gatishmërinë për të thelluar bashkëpunimin me Shqipërinë në të gjitha fushat.

“Ne jemi të gatshëm të punojmë me të gjithë sektorët e Shqipërisë për të thelluar besimin e ndërsjellë politik, për të zgjeruar bashkëpunimin me interes reciprok dhe për të forcuar shkëmbimet ndërnjerëzore”, deklaroi ajo.

Njëherazi, ajo i bëri thirrje mediave shqiptare që të vijnë t’i kushtojnë vëmendje Kinës dhe të kontribuojnë në ndërtimin e një narrative të drejtë dhe gjithëpërfshirëse, në funksion të një partneriteti gjithnjë e më të fortë mes dy vendeve.

**Etleva Xhajanka**

# FED Invest mbështet fermerin në Kurbin, shembull i bujqësisë së qëndrueshme në Zhej

*Bujqësia e qëndrueshme në Zhej - Historia e Ndue Balozit që ndërtoi gjithçka me punë dhe përkushtim*

Në një nga zonat kodrinore të Kurbin, në Zhej, prej afro tre dekadash, jeta dhe puna e Ndue Balozit janë ndërthurur natyrshëm me tokën. Historia e tij është një dëshmi i qartë se bujqësia e qëndrueshme nuk është vetëm një koncept modern, por një mënyrë jetese e ndërtuar mbi përkushtimin, durimin dhe zgjedhjet e zgjuara.

Që prej fillimit të viteve '90, Balozit ka ngritur hap pas hapi aktivitetin e tij bujqësor, duke u mbështetur kryesisht në buqimet e veta dhe në një vizion afatgjatë. Sot, ai zotëron një sipërfaqe të konsiderueshme me ullinj rreth 18-vjeçarë, të mbjellë me sistem brezare – një investim i menduar që në fillimet e tij. Kujdesi për ullishten është i vazhdueshëm dhe i orientuar drejt praktikave natyrale: përdor pleh organik dhe ure, duke shmangur pesticidet, çka i mundëson të prodhojë vaj dhe produkte cilësore.

Por aktiviteti i tij nuk ndalet tek ullinjët. Në fermën e tij gjenden pula të rritura në kushte të lira, të cilat sigurojnë mish dhe vezë natyrale, si dhe një tufë dhish që kullosojnë në zonat malore përreth. Këto të fundit i japin mundësinë të ofrojë produkte të ndryshme të qumështit, të përshtatura sipas kërkesës së tregut – nga qumështi i freskët, tek djathi dhe hira.

E veçanta e këtij modeli qëndron në zhvillimin gradual dhe të qëndrueshëm. Çdo hap është ndërtuar me kujdes, pa rrezik të tepruar dhe me një lidhje të fortë me natyrën dhe tregun lokal.

Megjithatë, sfidat nuk kanë munguar. Së fundmi, reshjet e shumta shkaktuan rrëshqitje të tokës në pronën e tij, duke rrezikuar jo vetëm investimin, por edhe sigurinë e fermës. Përballë kësaj situatë, reagoni ishte i menjëhershëm. Me

mbështetjen financiare të FED Invest, kërkesa e tij për financim u miratua brenda ditës, duke i mundësuar ndërtimin e një muri mbrojtës për stabilizimin e terrenit.

Ky ndërhyrje në kohë jo vetëm shmangu dëme më të mëdha, por tregoi edhe rëndësinë e aksesit të shpejtë në financim për fermerët, sidomos në situata emergjente.

Historia e Ndue Balozit është më shumë sesa një rrëfim individual. Ajo përfaqëson një model të bujqësisë së qëndrueshme shqiptare, ku puna e ndershme, menaxhimi i kujdesshëm dhe përshtatja ndaj sfidave krijojnë bazat e një suksesi afatgjatë. Në një kohë kur zhvillimi rural kërkon modele konkrete, përvoja të tilla shërbejnë si frymëzim për brezat e rinj dhe si dëshmi se toka, kur punohet me përkushtim, gjithmonë shpërblen.

**Etleva Xhajanka**



Ambasadorja e Republikës Popullore të Kinës, Pang Chunxue, gjatë fjalës së saj në takim me median

“Informimi i drejtë dhe pasqyrimi objektiv i zhvillimeve në Kinë janë thelbësore për forcimin e mirëkuptimit dhe afërsimit të mëtejshëm mes popujve”, u shpreh ambasadorja, duke inkurajuar mediat shqiptare që përmes fjalës dhe kamerës të ndihmojnë publikun të njohë më mirë realitetin kinez.

## Roli i mediave në marrëdhëniet dypalëshe

Duke iu drejtuar drejtpërdrejt gazetarëve, Pang Chunxue theksoi rëndësinë e angazhimit të tyre në ndërtimin e një narrative të balancuar mbi Kinën.

“Shpresoj që miqtë e medias shqiptare të përdorin fjalët dhe kamerat e tyre për të ndihmuar më shumë njerëz të afrohen dhe ta kuptojnë Kinën”, tha ajo, duke shtuar se mediat mund të kontribuojnë në “shkrimin e një kapitulli të ri në marrëdhëniet Kinë-Shqipëri”.

## “Dy Sesionet” dhe vizioni strategjik i Kinës

Në fjalën e saj, ambasadorja u ndal te zhvillimet më të fundit politike në Pekin, duke vënë në dukje rëndësinë e “Dy Sesionëve”.

“Këto sesione u përqendruan në diskutime të thella mbi zhvillimin ekonomik dhe social, kultivimin e forcave prodhuese me cilësi të re, përmirësimin e jetesës së popullit dhe hapjen me nivel të lartë”, theksoi ajo.

Sipas Pang Chunxue, në këto sesione u miratuan dokumente kyçe, përfshirë Reportin e Punës së Qeverisë, i cili “sqaron objektivat e zhvillimit për vitin 2026 dhe drejtimet kryesore të Planit

di mbetet një faktor stabiliteti dhe zhvillimi.

“Gjatë pesë viteve të fundit, ekonomia e Kinës është rritur me një normë mesatare vjetore prej 5.4%, duke kontribuar rreth 30% në rritjen ekonomike globale”, deklaroi ajo.

Për vitin aktual, objektivi i rritjes ekonomike është “4.5%-5%”, i mbështetur nga investimet në teknologji, rritja e produktivitetit dhe zgjerimi i kërkesës së brendshme. Sipas saj, këto politika synojnë ta bëjnë ekonominë kineze “më të balancuar dhe të qëndrueshme”.

## Politika e hapjes dhe transformimi ekonomik

Një tjetër shtyllë e rëndësishme e fjalimit ishte politika e hapjes së Kinës ndaj botës.


“Kina do të vazhdojë të promovojë zhvillimin përmes hapjes”, u shpreh ambasadorja, duke shtuar se “lista negative për aksesin e investimeve të huaja është reduktuar në 29 kufizime dhe kufizimet në sektorin e prodhimit janë hequr plotësisht”.

Ajo vuri në dukje edhe transformimin e strukturës ekonomike, ku shpenzimet për shërbime kanë arritur në 46.1%, ndërsa një klasë e mesme në rritje prej mbi 400 milionë njerëzish po rrit kërkesën për produkte cilësore.

“Kina po shndërrohet nga ‘fabrika e botës’ në ‘tregun e botës’”, theksoi ajo.

## Mbështetja për tregtinë shumëpalëshe

Në planin ndërkombëtar, ambasadorja nënvizoi angazhimin e Kinës për një sistem



HISTORI SUKSESI NDUE BALOZI - ZHEJ KURBIN

# Salla: Zbatim rigoroz i legjislacionit në përputhje me standardet e BE në tregtimin e vezës

Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Andis Salla, së bashku me drejtoreshën e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (AKU), Blerina

tryezën teknike të organizuar nga AKU dhe Këshilli Ekonomik Kombëtar.

Në fokus të diskutimeve ishte përmirësimi i

dhe prodhimi i vezës së lëngshme.

Ministri Salla theksoi se diskutimet u përqendruan në zbatimin rigoroz të kërkesave të legjislacionit në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian, përmes implementimit të sistemit HACCP, forcimit të gjurmueshmërisë, etiketimit të saktë dhe përmirësimit të kushteve në stabilimentet e prodhimit.

Ai nënvizoi se këta elementë janë thelbësorë për garantimin e cilësisë dhe rritjen e besimit të konsumatorit.

Salla garantoj mbështetje të plotë për bizneset përmes komunikimit të hapur dhe profesional, duke theksuar njëkohësisht se do të ketë tolerancë zero ndaj çdo praktike që cenon sigurinë ushqimore dhe standardet e tregut.



Gjylameti dhe përfaqësues të Operatorëve të Biznesit Ushqimor (OBU), morën pjesë në

standardeve në zinxhirin e grumbullimit, paketimit dhe tregtimit të vezës kokërr, si



SHOQATAT ANËTARE

AVALB FEDINVEST BKFSH EKR IBMA HABA AOA UPM LEAA ADAMA ABA SHGF ALBAFLOR

SHKPVF RKUK SVP MSHKM BIOADRIA PPAM SHT UOTSH KEA BIOPANT ADAD PSN

KËSHILLAT RAJONALE

TIRANA DURRESI FIERI ELBASANI SHKODRA DIBRA  
LEZHA GJIROKASTRA KORÇA BERATI VLORA KUKESI



Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar

[www.kashalbania.org](http://www.kashalbania.org)

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar



# KREDI E SHPEJTË MIKRO PËR ÇDO QËLLIM BIZNES APO INDIVID

**KREDI MIKRO**

deri në **2,500,000** LEKË



# Rama: Bujqësia inteligjente shtyllë e zhvillimit ekonomik, synojmë 1 miliard euro eksporte bujqësore

Kryeministri Edi Rama u shpreh se bujqësia inteligjente mbetet fushë sfiduese që do ta ndihmojë vendin drejt arritjes së objektivit për 1 miliard euro eksporte.

Kryeministri Rama mori pjesë në edicionin e dytë të MatchMaker Albania, platforma e biznesit që bashkon investitorë, kompani dhe institucione vendase dhe ndërkombëtare, me mbi 1000 pjesëmarrës dhe më shumë se 400 takime të planifikuara.

Në fjalën e tij, Rama veçoi si shtyllë të zhvillimit ekonomik të vendit, bujqësinë inteligjente.

“Bujqësia inteligjente

shfaqet e duket ende si një fushë sfiduese, por ku po ndodhin shumë gjëra dhe shumë produkte prodhuar në Shqipëri po zhvillohen me shpejtësi mjaft të madhe”, tha kryeministri.

Sipas tij, prodhimet shqiptare tanimë mbërrijnë në tryezat e rreth 100 vendeve në mbarë botën.

“Ne besojmë fort se objektivit ynë për t’i çuar eksportet e këtij vendi të vogël në 1 miliard euro është brenda mundësisë sonë”, shtoi ai.

Një shtyllë tjetër e rëndësishme për zhvillimin ekonomik të vendit, sipas kryeministrit është ajo që ka të

bëjë me horizontet digjitale, teknologjinë, inteligjencën artificiale, sigurinë kibernetike dhe ekonominë digjitale.

“Jemi shumë krenarë që jemi vendi i parë që i ka lënë hapësirë edhe në qeveri një ministere për inteligjencën artificiale. Jemi mjaft të vetëdijshëm që digjitalizimi për ne përfaqëson bekim, si për shumë vende që janë në zhvillim, sepse është një mundësi unike për të kapërcyer para dhe për të mbyllur brenda një kohe shumë të shkurtër hendeqe historike që nuk do të mund të mbylleshin në afatin kohor të një brezi apo dy”, shtoi Rama.



# Ekspozita “Expoforest 2026”, një udhëtim në kohë kushtuar pasurisë pyjore të Shqipërisë

Agjencia Kombëtare e Pyjeve është shndërruar këto ditë në një hapësirë të veçantë ekspozuese, duke mirëpritur “Expoforest 2026”, një udhëtim në kohë dhe dije, kushtuar pasurisë pyjore të Shqipërisë.

Kryeministri Edi Rama ndau në rrjetet sociale momente nga kjo ekspozitë, e cila do të jetë e hapur deri më datë 31 mars.

“Në ekspozitë prezantohen dokumente, studime dhe azhurmime të fondit pyjor të hartuara nga ish-Instituti i Pyjeve dhe Kullotave, instrumente të përdorura në dekada për matjet e pyjeve si dhe materiale interesante me vlerë arkivore”, theksoi Rama.

Në këtë ekspozitë vizitorët do të kenë mundësi të njihen edhe me instrumentet historike të përdorura për matjet pyjore, si dhe me materiale me vlerë të rrallë arkivore, të cilat janë një dëshmi e përkushtimit ndër vite për mbrojtjen dhe

menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve.



# Kompania shqiptare, qasje të re në trajtimin e bimëve aromatike medicinale

Kompania “Amel” në Elbasan, një sipërmarrje dhe qendër kërkimore e njohur, ka sjellë një qasje të re në trajtimin e bimëve aromatike medicinale dhe mbetjeve organike.

Ministri i Mjedisit, Sofjan

Jaupaj, theksoi se në këtë kompani, përpunohen mbi 80 lloje bimësh me përdorim inovativ të mbetjeve

organike nga bujqësia dhe akuakultura.

“Ky model dëshmon se ajo që dikur konsiderohej “mbetje”, sot mund të kthehet në vlerë të shtuar për ekonominë”, tha Jaupaj.

Ndërkohë, Lindita Vrushti, një prej bashkëthemeluesve të kompanisë, shprehet se ky është një biznes familjar që ka nisur në 2008.

“Nuk deshëm që bimët medicinale të ekstraktoshin me teknologjinë aktuale siç ishte distilimi apo me tretësia të tjerë kimik, por zgjedhëm një teknologji inovative, të gjelbër, pa mbetje. Këtë teknologji e morëm dhe implementuam në gjithë bimët medicinale. Kuptuam që tregjet kërkojnë bimë të pastra nga natyra, industria farmaceutike, ajo ushqimore, kozmetika natyrale, por edhe industri të tjera që prodhojnë ushqim për kafshët, por edhe biostimulues të tokës”, tha ajo.



Jaupaj tha se me këtë qasje, hiqet dorë nga teknologjitë tradicionale të ekstraktimit.

“AMEL po aplikon në Shq-

porim inovativ të mbetjeve

# Jaupaj mbledh Këshillin Kombëtar të Faunës, konkretizohen hapat për zbatimin e ligjit për Gjuetinë

Ministri i Mjedisit, Sofjan Jaupaj ka mbledhur një ditë më parë Këshillin Kombëtar të Faunës u vendos në fokus zbatimi i ligjit për Gjuetinë, duke diskutuar hapat konkretë për ta bërë atë efektiv dhe të zbatueshëm në terren.

Jaupaj së bashku me përfaqësues të shoqatave të mjedisit dhe të gjuetarëve dhe ekspertë të Ministrisë së Mjedisit, diskutuan për hartimin e akteve nënligjore, Programin Kombëtar të Zhvillimit të Gjuetisë, menaxhimin e zonave të gjuetisë, si edhe përcaktimin e një sistemi transparent dhe të drejtë tarifash.

Ministri theksoi se “bashkitë dhe federatat e gjuetarëve do të kenë një rol të rëndësishëm si aktorë kyç në menaxhimin e qëndrueshëm të faunës së egër, në bashkëpunim me ekspertizën shkencore për përgatitjen e listës së llojeve objekt gjuetie”.

Moratoriumi për gjuetinë, pas më shumë se një dekade,

është hequr, duke lejuar këtë aktivitet në zona të caktuara, sipas rregullave të parashikuara në ligjin e ri të “Për gjuetinë”.

Zonat e lejuara për gjueti shtrihen në sipërfaqe jo më të vogla se 500 ha në zonat fushore dhe jo më të vogla se 1000



Tashmë ligji mbron të drejtën e gjuetarëve dhe nxit bashkëpunimin midis tyre dhe bashkëpunim me ekspertizën shkencore të zonës, si dhe mes strukturave të parashikuara në këtë ligj për ruajtjen dhe menaxhimin e faunës së egër dhe të habitatit të saj.

ha në zonat malore, ndërsa rezervatet e mbarështimit të llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie, krijohen në sipërfaqe jo më të vogla se 50 ha dhe kufijtë i propozohen ministrisë nga njësitë përgjegjëse për gjuetinë.

# Prezantim dinjitoz i stendës shqiptare në panairin Expo Food në Athinë

Ambasadorja e Shqipërisë në Greqi, Luella Hajdaraga vizitoi stendat shqiptare në ditën e dytë të panarit Expo Food Greece 2026 në Athinë.

Ambasadorja përgëzoi përfaqësuesit e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA) për organizimin dhe prezantimin dinjitoz të stendës shqiptare, ku po promovohen produkte tradicionale dhe cilësore shqiptare si kafë,

verë, turshi dhe komposto, vaj ulliri, lëngje frutash bio si dhe bimë medicinale.

Gjatë vizitës, Hajdaraga

u takua me gjashtë kompanitë shqiptare pjesëmarrëse dhe i përgëzoi për punën dhe përkushtimin në prodhimin e produkteve shqiptare me standarde të larta cilësie.

Ambasadorja i inkurajoi që të vazhdojnë të promovojnë dhe të zhvillojnë produktet shqiptare, duke konkurruar me sukses në tregjet ndërkombëtare, në të njëjtin nivel me kompanitë evropiane.



## Jaupaj dakordësi me operatorët e rafting, zgjatet sezoni i lundrimit në Vjosë

Ministri i Mjedisit, Sofjan Jaupaj zhvilloi takim me operatorët e rafting që kryejnë aktivitetin në lumin e Vjosës.

Gjatë takimit u diskutuan nevojat dhe sfidat e tyre, me fokus zgjatjen e sezonit të rafting dhe shtimin e vendqëndrimeve përgjatë gjithë gjatësisë së lumit.

drimit me mjete të lehta jomotorike në lumin Vjosa të jetë në afatin kohor 1 prill deri më 30 nëntor 2026.

Urdhri i vjetër i cili parashikonte datat 1 maj-15 tetor do të shfuqizohet.

Jaupaj informoi se pati dakordësi që operatorët do të lidhin marrëveshje me Zyrën e

veçanërisht Vjosa, janë kthyer në një pasaportë të turizmit të qëndrueshëm të Shqipërisë në botë. Për këtë arsye Ministria e Mjedisit mbetet e angazhuar të trajtojë çdo problematikë të komuniteteve dhe sipërmarrjeve ekoturistike, për të gjetur ekuilibrin mes mbrojtjes së biodiversitetit dhe ekoturizmit”, tha Jaupaj.

Në këtë tryezë të përbashkët me kryetaren e bashkisë Përmet Alma Hoxha, Agjencinë e Zonave të Mbrojtura dhe Zyrën e Administrimit të Parkut Kombëtar të Lumit Vjosa, u ndanë ide dhe hapa konkretë për zhvillimin e mëtejshëm të këtij aktiviteti.

Lumi Vjosa, i njohur si “lumi i fundit i egër në Evropë”, po kthehet në një destinacion gjithnjë e më të preferuar për adhuruesit e natyrës dhe sporteve ekstreme. Të apasionuar pas sporteve ekstreme, turistë të shumtë rëndin në rrjedhën e Vjosës për të përjetuar eksperiencën unike të rafting.

Turistët e aventurës përshkëllojnë lumin nga Përmeti deri në Këlcyrë me një gjatësi gati 20 km.



Të gjitha palët në takim, bashkia Përmet, Parku Kombëtar i Vjosës, Federata Shqiptare e Raftingut dhe operatorët turistikë përmetarë pas uljes në tryezën e bisedimeve ranë dakord që sezoni i ri i lund-

Vjosës për tarifat mujore, duke krijuar një kuadër më të qartë dhe të organizuar për ushtrimin e rafting.

“Në kushtet kur sezoni turistik po nis gjithnjë e më herët, zonat e mbrojtura, e

## Sipërmarrësit e rinj që “rishpikën” vajin e ullirit në Belsh

(Vijon nga faqja 4)

çdo ditë. Ne nuk dimë gjithçka.” Ky vendim riformësoi të ardhmen e tyre.

Me mbështetjen e një konsulenteje të dedikuar të GYB, ata forcan kapacitetet e tyre teknike dhe menaxheriale. Përmirësuan njohuritë mbi Praktikën e Mira të Prodhimit dhe metodologjinë 5S. Rishikuan modelin e tyre të biznesit. Fituan qartësi mbi kostot, burimet e të ardhurave dhe tërheqjen e klientëve. Mësuan se marketingu ndërton “pozicionim” - jo vetëm vizibilitet. Forcuan planifikimin financiar dhe praktikën e qëndrueshmërisë.

Më e rëndësishmja, ndryshuan mënyrën e të menduarit.

Fabrika nuk ishte më thjeshtë një vend për të shtrydhur ullinjët.

Ajo u bë një “markë” në zhvillim.

Ata morën pjesë në webinarë ndërkombëtare të agritech-ut, iu bashkuan “Export ON 2026” dhe filluan të eksplorojnë tregje të reja. Ridizenuan modelin e biznesit - duke kaluar përtej përpunimit me shumicë drejt një linje premium vaj ulliri ekstra të virgjër, të ambalazhuar, të nxjerrë në të ftohtë dhe me origjinë të vetme.

“Ajo që më bëri më shumë përshtypje tek Heraldo dhe Sabjani ishte përpunimi i tyre,” thotë Alketa Qëndro, konsulentja e biznesit që i mbështet.

“Pavarësisht se drejtonin tashmë një fabrikë funksionale, ata vinin në çdo seancë si nxënës. Bënin pyetje, mbanin shënime dhe - më e rëndësishmja - zbatonin menjëherë atë që mësonin. Ata nuk morën pjesë thjeshtë në trajnim; e kthyen njohurinë në veprim.”

Ajo telefonatë u dha drejtim. Dhe drejtimi ndryshoi gjithçka.

### 2030: Një shishe me histori

Ëndrra e tyre është e guximshme: vaj ulliri ekstra premium, i nxjerrë në të ftohtë, me prodhim të kufizuar dhe me origjinë të vetme.

Jo thjeshtë i shitur me litra. Por i ambalazhuar me identitet. I gjurmueshëm. I pastër. I qëndrueshëm.

Një imazh i ri tregtar është gati tashmë për kompaninë e tyre.



Imazh i ri tregtar

Gjithashtu, ata shpejt do të kenë edhe faqen e tyre të parë të internetit.

Është për të rinjtë që zgjedhin të qëndrojnë në vendin e tyre - jo ta braktisin atë. E koha ka ardhur për ta bërë pyetjen pak më ndryshe. Jo “Ku e shihni veten në vitin 2030?”,

por “Çfarë mund të ndërtohet që edhe të tjerët ta shohin veten këtu në 2030?”



Nora Kushti, Specialiste e Komunikimit në UNDP Albania, duke biseduar me Heraldon mbi përvojën dhe rrugëtimin e tij me metodologjinë GYB

Tregje të reja janë në horizont - konsumatorë gourmet, destinacione eksporti.

Sepse vaji i ullirit ka sezonin e vet, por ambicia e tyre jo.

Ata po zgjerojnë idetë përtej prodhimit. Po diversifikojnë burimet e të ardhurave. Po stabilizojnë modelin e tyre të biznesit. Ata nuk po ndërtojnë një fabrikë sezonale. Ata po ndërtojnë qëndrueshmëri.

Kjo nuk është thjeshtë një histori për ullinjët. Është një histori rikthimi në vendin tënd. Është një histori ku pasiguria për të ardhmen kthehet në strategji të qartë biznesi.

E sa për Heraldon dhe Sabjanin, ata janë më të qartë se kurrë. Ata shohin një fshat ku fermerët nuk shesin produkte me çmime të lira dhe të papërpunuara.

Ata shohin vlerë të shtuar në nivel lokal.

Ata shohin vende pune të krijuara në nivel lokal.

Shohin Grekanin në hartën e Mesdheut - jo si një pikë të harruar, por si një origjinë premium.

Dhe në vitin 2030, kur dikush do t'i pyesë se ku e shohin veten - Ata thjeshtë do të mbajnë lart një shishe. Dhe do të thonë:

“Pikërisht këtu.”

## Jaupaj: Ekonomia qarkulluese dhe riciklimi në qendër të politikave tona

Dita Botërore e Riciklimit, që festohet çdo vit më 18 mars është mundësi për të edukuar njerëzit mbi përfitimet e riciklimit dhe për të promovuar politikën dhe iniciativat që mbështesin menaxhimin e mbetjeve dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Riciklimi ndihmon në uljen e ndotjes, pasi përpunimi i materialeve të ricikluara përdor më pak energji dhe krijon më pak ndotje se sa prodhimi i materialeve të reja.

Ministri i Mjedisit, Sofjan Jaupaj tha se “kjo ditë na kujton se mbrojtja e mjedisit fillon nga veprimet tona të përditshme”.

“Përmes ndarjes së mbetjeve, ripërdorimit të materialeve dhe reduktimit të konsumit, secili prej nesh mund të kontribuojë drejtpërdrejt në ruajtjen e burimeve natyrore dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike”, theksoi Jaupaj.

Jaupaj tha se “vendi ynë po ecën drejt një modeli të qëndrueshëm zhvillimi, ku ekonomia qarkulluese dhe riciklimi janë në qendër të politikave dhe vizionit për të ardhmen, në përputhje me standardet e Bashkimit Europian”.

Riciklimi i mbetjeve konsiderohet si potencial për të krijuar vlerë të re, ndërsa filozofia “Qarkullo dhe krijo” po përqafohet gjithmonë e më shumë nga bizneset shqiptare.

Vitin e kaluar Kuvendi i Shqipërisë miratoi projektligjin

“Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i cili reflekton standardet më të lartë të BE-së në përputhje me kërkesat e Kapitullit 27 për mjedisin dhe ndryshimet klimatike.

Në disa rajone të vendit janë ndërtuar dhe janë vënë në funksion disa landfille moderne, të projektuara sipas direktivave të BE-së për sigurinë mjedisore. Në të njëjtën kohë janë ngritur impiante të

reja të trajtimit të mbetjeve. Një hap tjetër i rëndësishëm është zhvillimi i impianteve të kompostimit dhe riciklimit, struktura që jo vetëm ndihmojnë në përpunimin e mbetjeve organike dhe materialeve të riciklueshme, por kanë krijuar gjithashtu mundësi të reja për ekonominë vendase duke gjeneruar vende pune dhe duke forcuar sektorin privat.



REPUBLIKA E SHQIPËRIE  
MINISTRIA E MJEDISIT



**Dita**  
**Ndërkombëtare**  
**e Riciklimit**





**Riciklo sot.**  
**Ruaj të ardhmen.**

## Betejë pas beteje - Si mund t'i mbijetojë prodhimi shqiptar zinxhirit global të krizave ushqimore?

(Vijon nga faqja 5)

**Ndërhyrje në zinxhirin e tregtimit dhe grumbullimit:** Shpesh, diferenca e çmimit nga fusha në dyqan është abuzive. Institucionet duhet të monitorojnë me rreptësi marzhet e fitimit të ndërmjetësve. Rritja e kostos në fermë nuk duhet të përdoret si justifikim për rritje spekulative të çmimeve për konsumatorin fundor.

**Krijimi i rezervave strategjike të inputeve:** Ashtu siç shtetet mbajnë rezerva floriri apo karburanti, ka ardhur koha të mendohet për krijimin

e rezervave strategjike të farëve dhe plehrave kimike për të amortizuar goditjet e befasishme të çmimeve në tregjet botërore, duke i ofruar fermerëve çmime të stabilizuara në kohë krize.

**Tranzicioni energjetik në ferma:** Rritja e çmimeve të gazit dhe energjisë elektrike e bën urgjente mbështetjen me grante për vendosjen e paneleve diellore, veçanërisht për serat dhe stabilizimet blegtorale e përpunuese, duke ulur kështu kostot fikse në një të ardhme afatmesme.

Lufta në Ukrainë na dha një

leksion të hidhur se sa e brishtë është siguria ushqimore. Tani, me një krizë të re që po zë vend dhe po mbyl ekonominë, nuk e kemi luksin të presim e të shohim. Nevojitet një plan kombëtar që e ndan barrën mes shtetit, prodhuesve, përpunuesve, tregtarëve, në mënyrë që faturën e kësaj “beteje të radhës” të mos e paguajnë as me falimentim fermerët, e as me çmime stratosferike konsumatorët. Dhe për politikën është më mirë të kemi sa më shumë prodhim vendas si një mënyra më efikase që lufton inflacionin e importuar.

“Monitor”

## SUBVENCIONE

# Miratohet Skema Kombëtare e Bujqësisë 2026: Rriten subvencionet për lopët, bagëtitë dhe të mbjellat

Këshilli i Ministrave miratoi Skemën Kombëtare të Bujqësisë për vitin 2026, me një fond prej 2.5 mld lekësh apo rreth 25 mln euro, e cila do të rrisë mbështetjen me subvencione direkte për fermerët që mbarështojnë lopë, bagëti të imëta, bletë, derra dhe produkte të tjera bujqësore.

Sipas Ministrisë së Bujqësisë, krahasuar me vitin 2025, mbështetjet direkte janë rritur si më poshtë:

Mbështetja për lopët: nga 10 mijë lekë për krerë që ishte më parë arrin në 12 mijë lekë për krerë.

Mbështetja për koshere bletësh: nga 10 mijë lekë që ishte më parë arrin në 20 mijë lekë

Mbështetja për bagëti të imëta: nga 1,200 lekë arrin në 1,500 lekë

Për herë të parë, përfshihet mbështetja për dosët në sektorin e derrave. Mbështetja do të jetë 7 mijë lekë për dosë në një fermë me jo më pak se 5 dosa.

Skema e re do të jetë më gjithëpërfshirëse për sektorin e blegtorisë, pasi përgjysmon pragjet e numrit të kafshëve në fermë, për përfitim të subvencioneve:

Ferma me jo më pak se 5 lopë nga jo më pak se 10 lopë që ishte më parë.

Ferma me 50 krerë të imëta nga 100 krerë që ishte në skemën e mëparshme.

Rritësit e bletëve me jo më pak se 25 koshere nga jo më pak se 50 koshere që ishte më parë.

Për kontrollin biologjik të dëmtuesve në sera, mbështetja rritet në 70% të kostos së shpenzimeve, nga 50% që ishte më parë.

Skema e re synon të mbështesë më shumë fermerë dhe të rrisë efektivitetin e subvencioneve direkte për sektorin bujqësor.

Ndërsa një masë tjetër që na përafrohet me pagesat që zbatohen në BE është pagesa për sipërfaqe të mbjelle. Fermat me mbi 3 ha përfitojnë 10 mijë lekë për çdo ha të mbjellë.

Edhe këtë vit, shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor (SHBB) do të mbështeten në 100% të masës së përfitimit.

Mbështeten fermerë të rinj, për investime në ferma bujqësore dhe blegtorale, masa e përfitimit është në 70% e vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 1 000 000 (një milion) lekë; Subjektet e rritjes së peshkut në ujërat e brendshme mbështeten me 200 mijë lekë për blerje rasati.

## Vendimi

### PËRCAKTIMIN E KRITEREVE BAZË TË SEKTORËVE QË DO TË MBËSHTETEN DHE TË MASËS SË FINANÇIMIT NGA FONDI I PROGRAMIT PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL, PËR VITIN 2026

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3, të nenit 6, të ligjit nr.9817, datë 22.10.2007, "Për bujqësinë dhe zhvillimin rural", të shkronjës "c", të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr.64/2012, "Për peshkimin", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.87/2025, "Për buxhetin e vitit 2026", me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

1. Fondi i miratuar në buxhetin e vitit 2026 për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në zërin "Transferti në buxhetet familjare" (Ilogaria ekonomike 606), përdoret për:

a) rritjen e konkurrencës së prodhimeve bujqësore dhe blegtorale, duke ulur kostot nëpërmjet pagesave direkte për sipërfaqe të kultivuar dhe për kafshë të matrikulluara;

b) kontrollin biologjik të dëmtuesve të perimeve në serra, certifikimin e produkteve bujqësore dhe të fermave organike;

c) mbështetjen me grante për investime në ferma, agropërpunim, akuakulturë dhe agroturizëm.

2. Masat e mbështetjes dhe masa e financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural janë, si më poshtë vijon:

2.1. Pagesa direkte në bujqësi dhe blegtori është, si më poshtë vijon:

a) Në vlerën deri në 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë/krerë, për tufën bazë të matrikulluar (kafshët riprodhuese), për fermer/aplikant, me jo më pak se 5 (pesë) krerë lopë dhe/ose mëshqerra.

Për pjesën mbi 50 (pesëdhjetë) krerë, masa e përfitimit zvogëlohet me 50%, përjashtuar rastet e aplikantëve me status "Shoqëri të bashkëpunimit bujqësor (në vijim SHBB)";

b) Në vlerën deri në 1 500 (një mijë e pesëqind) lekë/krerë



për tufën bazë të matrikulluar (kafshët riprodhuese), për fermer/aplikant, me jo më pak se 50 (pesëdhjetë) krerë dele dhen/ose dhi.

Për pjesën mbi 300 (treqind) krerë, masa e përfitimit zvogëlohet me 50%, përjashtuar rastet e aplikantëve me status "SHBB";

c) Për mbarështimin e bletarisë, në vlerën deri në 2 000 (dy mijë) lekë për zgjua, për fermer/aplikant, me jo më pak se 25 (njëzet e pesë) zgjoje.

Për pjesën mbi 150 (njëqind e pesëdhjetë) zgjoje, masa e përfitimit zvogëlohet me 50%, përjashtuar rastet e aplikantëve me status "SHBB";

ç) Për dosa dhe/ose paradosa të matrikulluara, në vlerën deri në 7 000 (shtatë mijë) lekë/krerë dosë/paradosë, për fermer/aplikant, me jo më pak se 5 (pesë) krerë dosa dhe/ose paradosa.

Për pjesën mbi 100 (njëqind) krerë, masa e përfitimit zvogëlohet me 50%, përjashtuar rastet e aplikantëve me status "SHBB";

d) Për kontrollin biologjik të dëmtuesve të perimeve (domate, specat, tranguj) në serra dhe/ose luleshtrydheve në tunele plastike, masa e përfitimit është 70% e vlerës totale të faturave tatimore, për blerjen e materialeve biologjike, përfshirë insektet e dobishme, por jo më shumë se 40 000 (dyzet mijë) lekë për dynym, në rastin e dy mbjelljeve në vit.

Për fermerët individualë, që aplikojnë për mbështetje për kontrollin biologjik, sipërfaqja minimale e kultivuar është 1 (një) dynym, ndërsa për aplikantët me status "SHBB", sipërfaqja minimale është 1 (një) ha, për secilën nga mbjelljet;

dh) Për fermat organike për periudhën në kalim, vitin e parë, në vlerën 100 000 (njëqind mijë) lekë, në vitin e dytë 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, në vitin e tretë 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë dhe 200 000 (dyqind mijë) lekë për fermë të certifikuar;

e) Për implementimin dhe certifikimin global GAP, përfshirë mbulimin e kostove të analizave të produkteve në perime, fruta, rrush, ullinj, agrume dhe kultura të tjera bujqësore të certifikueshme, në masën 50% të vlerës totale të faturës tatimore, por jo më shumë se:

i. 175 000 (njëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë, për sipërfaqe jo më pak se 1 (një) ha për certifikim individual;

ii. 500 000 (pesëqind mijë) lekë, për sipërfaqe jo më pak se 3 (tre) ha në ambiente të mbrojtura dhe jo më pak se 10 (dhjetë) ha në fushë të hapur, për certifikim në grup, me minimumi 10 (dhjetë) fermerë të përfshirë;

iii. 700 000 (shtatëqind mijë) lekë, për sipërfaqe jo më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) ha në ambiente të mbrojtura dhe jo më pak se 30 (tridhjetë) ha në fushë të hapur, për certifikim në grup, me minimumi 20 (njëzet) fermerë të përfshirë.

ë) në vlerën deri në 10 000 (dhjetë mijë) lekë për ha, për sipërfaqe të mbjellë me kultura bujqësore. Sipërfaqja totale, për të cilën aplikohet, duhet të jetë jo më pak se 3 (tre) ha.

Për sipërfaqe mbi 10 (dhjetë) ha, masa e përfitimit zvogëlohet me 50%, përjashtuar rastet e aplikantëve me status "SHBB";

f) për mbështetje për aktivitetin ripullim peshkimi për ujërat e brendshme për blerje rasate peshku, masa e përfitimit është në 50% e vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 200 000 (dyqind mijë) lekë për subjekt.

### 2.2. Mbështetje për investime për:

a) masat e përcaktuara në shkronjat "a", "b", "c", "ç", "d", "dh", "e", "ë" dhe "f", të nënpikës 2.4, të vendimit nr.150, datë 6.3.2025, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës

së financimit nga fondi i programit për bujqësinë e zhvillimin rural, për vitin 2025", të ndryshuar;

b) fermerë të rinj, për investime në ferma bujqësore dhe blegtorale, masa e përfitimit është në 70% e vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 1 000 000 (një milion) lekë;

c) ndërtimin/rikonstruksionin e staneve dhe/ose pajisjeve për përmirësimin e kushteve, masa e përfitimit është në 70% e vlerës së faturave tatimore, por jo më shumë se 3 000 000 (tre milionë) lekë për subjekt.

ç) pajisje, makineri dhe mjete bujqësore për mekanizimin dhe modernizimin e proceseve të punës në ferma bujqësore dhe blegtorale, masa e përfitimit është në 50% e vlerës së faturave tatimore, por jo më shumë se 500 000 (pesëqind mijë) lekë për subjekt dhe jo më pak se 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë për subjekt.

3. Fondi total për mbështetjen për investime, të përcaktuara në shkronjat "a", "b", "c", "ç" dhe "d", të nënpikës 2.2, është në vlerën deri në 2 500 000 000 (dy miliardë e pesëqind milionë) lekë.

4. Nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2026, përdoret shuma deri në:

a) 159 954 159 (njëqind e pesëdhjetë e nëntë milionë e nëntëqind e pesëdhjetë e katër mijë e njëqind e pesëdhjetë e nëntë) lekë, për pagesën e vlerës së palikuiduar për kontratat, për të cilat nuk është autorizuar pagesa finale në masat e mbështetjes për investime nga Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural, në zbatim të pikave 2.3 dhe 3/2, të vendimit nr.130, datë 6.3.2024, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2024", të ndryshuar;

b) 9 662 269 (nëntë milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë, për pagesën e vlerës së palikuiduar, për subjektet përfituese, në zbatim të vendimit nr.150, datë 6.3.2025, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2025", të ndryshuar.

5. Për masat mbështetëse sipas shkronjave "a", "b", "c", "ç", "d", "dh", "e", "ë" dhe "f", sipas përcaktimeve të nënpikës 2.1, kur fondi në dispozicion rezulton më i vogël se totali i kërkesës së aplikimeve të bëra për masën përkatëse, vlera e financimit që përfitohet për njësi (krerë, zgjua apo ha), si dhe në total për subjekt, reduktohet në përputhje me këtë fond. Në rastet e shtesave/alokimeve eventuale të fondit, vlera e financimit që përfitohet nuk mund të jetë më e madhe se kufiri për masën përkatëse, i përcaktuar në këtë vendim.

Nga rregulli i mësipërm bëjnë përjashtim aplikantët me status "SHBB", të cilët përfitojnë vlerën maksimale të financimit, të parashikuar në këtë vendim, edhe kur fondi në dispozicion rezulton më i vogël se totali i kërkesës së aplikimeve të bëra për masën përkatëse.

6. Për aplikimet për masat mbështetëse, sipas shkronjave "a", "b", "c" dhe "ç", të nënpikës 2.1, të këtij vendimi, kryhet kontrolli në terren për verifikimin faktik të numrit të krerëve/zgjojeve, në jo më pak se 30%, të subjekteve përfituese, ndërsa për aplikimet sipas shkronjës "ë", në jo më pak se 10% të subjekteve përfituese, përfshirë kontrollin e të gjitha subjekteve me sipërfaqe mbi 10 (dhjetë) ha.

Çdo subjekt, në rastet kur verifikohet se ka përfituar më shumë se 20% nga vlera, për të cilën plotëson kriteret, përjashtohet 3 (tre) vjet nga e drejta e përfitimit prej masave mbështetëse për bujqësinë dhe zhvillimin rural, të financuara nga buxheti i shtetit.

7. Përfitues për masat e mbështetjes nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural janë fermerët individualë, personat fizikë, personat juridikë dhe shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor (SHBB).

8. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për zbatimin e këtij vendimi.

*Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".*

KËNDI I EKSPERTIT

# Kalendari bujqësor, muaji prill 2026

Përgatitur nga Prof. As. Dr. Eqrem Meçollari

## Pamja e qiellit gjatë muajit prill 2026

Më 2 prill - Hëna e Plotë. Hëna do të jetë e vendosur në anën e kundërt të Tokës me

Për referencë, më 3 gusht, dita më e nxehtë e vitit, temperatura në Tiranë zakonisht variojnë nga 18° C në 32° C, ndërsa më 4 janar, dita më e ftohtë e vitit, ato shkojnë nga

### Parashikimi i motit për muajin prill 2026 në Tiranë (Zona bregdetare)

Dt.	Temperatura e ajrit °C				Shiu		Era				UV Indeks	Përshkrimi i shkurtër i motit	Simboli
	Min.	Max.	Ndihet N-D-H	mm	Orë	Km/Orë		Drejtimi					
						D	N	D	N				
1	8	17	9/17/2016	6.9	3.5	9	6	J	J	3	Kryesisht vranësirë me disa shira dhe stuhi	☁	
2	7	16	5/17/2016	8.3	4	7	7	JJL	VVL	2	Vranësirë me disa shira dhe stuhi pasdite	☁	
3	6	16	4/17/2015	0.5	0.5	13	9	VL	VVL	6	Një shi në kalim në mëngjes;pastaj pjesërisht me diell	☁	
4	6	16	7/18/2015	0	0	11	7	VVL	PJP	6	Kryesisht me diell	☀	
5	7	16	6/19/2015	3.2	2	7	13	J	V	3	Interval re dhe diell me disa reshje dhe stuhi pasdite	☁	
6	7	16	6/17/2015	0	0	11	13	VVL	VVL	3	Kryesisht me re	☁	
7	8	17	6/19/2016	0	0	9	9	VVL	V	6	Diell dhe disa re	☀	
8	7	17	8/20/2016	0	0	11	7	VVL	VP	6	Diell	☀	
9	8	17	9/18/2018	4.8	5	4	6	JJP	JP	2	Vranësirë; një shi i vogël në mëngjes,	☁	
10	8	17	7/19/2016	0.5	0.5	7	13	VVL	V	4	Një stuhi me pika në mëngjes; pastaj vranësirë e ndrueshme	☁	
11	8	17	8/21/2016	0	0	9	9	VVL	V	7	Diell deri pjesërisht me re	☀	
12	8	17	10/22/2017	0	0	7	4	JJL	V	7	Kryesisht me diell	☀	
13	9	18	7/22/2017	10.3	7	7	6	JL	JL	7	Pjesërisht me diell	☀	
14	10	18	9/18/2017	9.9	5	13	11	VL	VL	2	Shi në mëngjes.pastaj plot me re	☁	
15	9	18	8/22/2017	0	0	11	15	VVL	VVL	7	Pjesërisht me diell	☀	
16	9	18	7/22/2017	0	0	11	11	VVL	VL	7	Largimi i reve	☀	
17	9	17	9/21/2017	0	0	11	7	VL	VVL	7	Diell dhe pak re	☀	
18	10	19	10/19/2016	18.7	5	13	7	J	J	3	Kryesisht me vranësirë me ndonjë shi pasdite	☁	
19	9	19	6/20/2017	12.3	8.5	11	18	JJL	JJL	4	Kryesisht me vranësirë me ndonjë shi pasdite	☁	
20	11	20	6/18/2017	19.2	7	11	9	JJP	JP	2	Kryesisht vranësirë me shira dhe stuhi	☁	
21	10	18	7/18/2018	11.3	6	13	10	JL	JJL	3	Periudhë me shi	☁	
22	10	18	8/19/2017	4.5	3	12	8	PVP	JJL	4	Vranësirë, me disa shira dhe stuhi pasdite	☁	
23	12	19	9/18/2018	8.5	5	13	5	VP	JL	2	Periudhë me shi	☁	
24	10	20	11/21/2018	5	4	14	8	VVP	L	3	Një prekje shiu në mëngjes, pastaj plot me re	☁	
25	10	20	9/19/2019	8.3	4	18	8	VVP	JL	2	Shi dhe stuhi në mëngjes, pastaj vranësirë e madhe	☁	
26	11	20	10/21/2018	3.3	3	18	11	JJP	JJP	3	Vranësirë e madhe me disa shira dhe stuhi pasdite	☁	
27	11	20	7/21/2018	1.7	3	17	9	JJP	JL	3	Vranësirë e madhe;një shi i vogël pasuar me shi me	☁	
28	14	23	8/21/2020	0	0	14	8	JP	JL	3	Pjesërisht me diell	☀	
